



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 27

Tiranë – E hënë, 22 shkurt 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 8/2016 datë 11.2.2016	Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar..... 2323
Ligj nr. 9/2016 datë 11.2.2016	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”..... 2323
Udhëzim i ministrit të Mjedisit nr. 1, datë 11.2.2016	Për miratimin e metodikave të regjistrimit dhe inventarizimit të llojeve të faunës së egër objekt gjetie dhe popullatave të tyre, si dhe formati i dokumentit, ku pasqyrohen të dhënat dhe rezultatet e inventarizimit..... 2324
Udhëzim i ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nr. 4, datë 15.2.2016	Për procedurat në zbatim të ligjit nr. 146/2015, datë 17. 12. 2015, “Për punëkërkuesit”..... 2344



LIGJ
Nr. 8/2016

**PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM
NË LIGJIN NR. 7926, DATË 20.4.1995, “PËR
TRANSFORMIMIN E NDËRMARRJEVE
SHTETËRORE NË SHOQËRI
TREGTARE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, bëhet shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 4, në fund të fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Ushtrimi i së drejtës së përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore, përfshirë edhe të drejtën e emërimit të anëtarëve të këshillave mbikëqyrës, në shoqëritë elektro-energjetike, bëhet në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe në shoqëritë e gazit natyror bëhet në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror.”.

Neni 2

Në nenin 8, paragrafi i katërt ndryshohet si më poshtë:

“Anëtarët e këshillave mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore caktohen si më poshtë:

a) 2/3 e numrit të anëtarëve caktohen nga përfaqësuesi i pronarit, për pronën shtetërore;

b) 1/3 e numrit të anëtarëve propozohet nga ministri i linjës administrative apo nga organi i qeverisjes vendore, që përfaqëson shtetin, për shoqërinë shtetërore përkatëse.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARE
Valentina Leskaj

Miraturar në datën 11.2.2016

Shpallur me dekretin nr. 9436, datë 18.2.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 9/2016

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË LIGJIN NR. 33/2012 “PËR
REGJISTRIMIN E PASURIVE TË
PALUAJTSHME”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 22, pika 3 riformulohet si më poshtë:

“3. Një pjesë e të ardhurave, që do të rezultojnë të pashpenzuara në fund të vitit financiar, trashëgohen në buxhetin e vitit ushtrimor pasardhës dhe kalojnë në fondin rezervë vjetor, masa e krijimit dhe kriteret e përdorimit të të cilit caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Të ardhurat e tjera të papërdorura të vitit korrent mbarten në vitin buxhetor pasardhës dhe përdoren për investime në drejtim të regjistrimit fillestar, përmirësimit/përditësimit të të dhënave që administron Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, si dhe dixhitalizimit të sistemit dhe të të dhënave të pasurive të paluajtshme.”.

Neni 2

Në nenin 46, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Leja e ndërtimit regjistrohet nga regjistruesi brenda 15 ditëve nga data e depozitimit të saj. Pas regjistrimit të lejes së ndërtimit, regjistruesi, sipas kërkesave të paraqitura nga personat e interesuar, regjistron në regjistrin e veçantë, në të cilin është regjistruar leja e ndërtimit, aktet noteriale, si dhe kontratat e sipërmarrjes/porosisë të lidhura ndërmjet zhvilluesit të pronës, në cilësinë e



investitorit dhe pronarëve të truallit apo blerësve/porositësve të njëjësive individuale, që përbëjnë strukturën që do të ndërtohet, bazuar në lejen e ndërtimit. Zhvilluesit e pronës apo pronarët e truallit nuk mund të lidhin kontrata sipërmarrjeje apo porosie pa regjistruar lejen e ndërtimit.”

Neni 3

Në nenin 47, pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Kur në përfundim të procedurave përmbartimore, karabinaja kalon në pronësi të një banke kreditore, dhe në regjistrin e veçantë nuk është regjistruar asnjë akt tjetër noterial, ose kontratë sipërmarrjeje/porosie, sipas këtij neni dhe nenit 46, të ligjit, regjistruesi lëshon dokumente të përkohshme në favor të kryerjes së transaksioneve nga ana e bankës, e cila ka të drejtë të disponojë dhe të tjetërsojë me të tretët këtë pasuri, vetëm për ato njësi ndërtimore që janë të lira dhe nuk kanë akte noteriale të regjistruara më parë. Regjistrimi i karabinasë dhe certifikatat/vërtetimet e përkohshme janë të vlefshme deri në regjistrimin përfundimtar të ndërtimit të ri, sipas nenit 48 të këtij ligji.”

Neni 4

Dispozitë kalimtare

Përrjashtimisht, të gjitha të ardhurat e krijuara dhe të papërdorura të vitit 2015 do të mbarten në vitin 2016 dhe do të përdoren për projektet e investimeve në drejtim të regjistrimit fillestar, përmirësimit/përditësimit të të dhënave që administron Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, si dhe dixhitalizimit të sistemit e të dhënave të pasurive të paluajtshme.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARE

Valentina Leskaj

Miraturar në datën 11.2.2016

Shpallur me dekretin nr. 9437, datë 18.2.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Bujar Nishani

UDHËZIM

Nr. 1, datë 11.2.2016

PËR MIRATIMIN E METODIKAVE TË REGJISTRIMIT DHE INVENTARIZIMIT TË LLOJEVE TË FAUNËS SË EGËR OBJEKT GJUEITIE DHE POPULLATAVE TË TYRE, SI DHE FORMATI I DOKUMENTIT, KU PASQYROHEN TË DHËNAT DHE REZULTATET E INVENTARIZIMIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të nenit 55, pika 4, të ligjit nr. 10253, datë 11.3.2010, “Për gjuetinë”,

UDHËZOJ:

1. Miratimin e metodikave të regjistrimit dhe të inventarizimit të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie dhe popullatave të tyre, si dhe formati i dokumentit ku pasqyrohen të dhënat dhe rezultatet e inventarizimit për këto lloje, sipas aneksit që i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Procesi i inventarizimit organizohet e drejtohet nga Ministria e Mjedisit me pjesëmarrjen e instituteve kërkimore-shkencore, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Bashkive, OJF-ve e të shoqatave që mbulojnë fushën e biodiversitetit dhe të shoqatave të gjuetarëve.

3. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT

Lefter Koka

MANUAL

PËR MIRATIMIN E METODIKAVE PËR EFEKT TË REGJISTRIMIT DHE INVENTARIZIMIT TË LLOJEVE TË FAUNËS SË EGËR OBJEKT GJUEITIE DHE POPULLATAVE TË TYRE, SI DHE FORMATI I DOKUMENTIT KU PASQYROHEN TË DHËNAT DHE REZULTATET E INVENTARIZIMIT



KAPITULLI I

KËRKESAT DHE RREGULLAT PËR
EFEKT TË KRYERJES SË PROCESIT TË
INVENTARIZIMIT TË LLOJEVE TË
FAUNËS SË EGËR, OBJEKT GJUETIE

1. Inventarizimi i llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, është një proces që kryhet dy herë në vit. Ai shërben për të identifikuar llojet e faunës së egër, objekt gjuetie, për të pasqyruar gjendjen e tyre, sikurse dhe për të parashikuar masa për të bërë të mundur rritjen e numrit të individëve të tyre, nëpërmjet planeve vjetore apo 10-vjeçare të menaxhimit.

2. Inventarizimi kryhet mbi bazën e zonave të gjuetisë të miratuara, duke pasqyruar për çdo zonë gjuetie llojet e faunës së egër, objekt gjuetie, sasinë e tyre, shtesën natyrale vjetore të popullatës së secilit lloj, si dhe për të planifikuar sasinë e individëve që mund të gjuhen gjatë sezonit të ardhshëm në zonën konkrete.

3. Procesi i inventarizimit kryhet në periudhën e pranverës dhe të vjeshtës (mars dhe tetor).

4. Për shpendët migratorë ujorë që nuk folezojnë në Shqipëri aplikohen metodat e vrojtimit dhe të survejimit shumëvjeçar, në periudhën klimaks të migrimit, gjatë së cilës këto lloje janë prezente në Shqipëri.

5. Drejtoria e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura organizon dhe koordinon procesin në bashkëpunim me drejtoritë rajonale të Agjencisë së Zonave të Mbrojtura, bashkitë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Shërbimin Këshillimor të Ekstensionit në pyje. Këto struktura janë përgjegjëse për të gjithë procesin e inventarizimit të llojeve të faunës së egër objekt gjuetie, si dhe të regjistrimit të të dhënave, siç parashikohet në aktet përkatëse dhe në këtë udhëzim.

6. Të dhënat e inventarizimit, në përfundim të procesit, dërgohen në drejtorinë përgjegjëse për biodiversitetin në Ministrinë e Mjedisit, e cila i pasqyron ato në regjistrin përmbledhës përkatës.

7. Inventarizimi dhe regjistrimi i llojeve dhe popullatave të tyre për çdo zonë gjuetie, realizohet nën drejtimin e menaxhuesit të zonës së gjuetisë. Në proces marrin pjesë e bashkëpunojnë institutet kërkimore-shkencore, OJF-të e shoqatat që mbulojnë fushën e biodiversitetit, shoqatat e gjuetarëve dhe gjuetarët

e zonës, duke mbajtur parasysh kërkesat e veçanta të çdo lloji.

8. Inventarizimi kryhet, gjithashtu, dhe në sipërfaqet që nuk janë zona gjuetie. Ky proces në këto sipërfaqe drejtohet nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura. Në procesin e inventarizimit edhe në këtë rast marrin pjesë e bashkëpunojnë të njëjtët aktorë të përmendur në pikën e mësipërme.

9. Grupi i punës, programon dhe bashkërendon procesin e inventarizimit nga fillimi i tij e deri në përfundim, sipas afateve kohore të përcaktuara në këtë manual për çdo lloj.

KAPITULLI II

TEKNIKAT DHE METODAT QË
PËRDOREN NË INVENTARIZIM,
FORMATI I DOKUMENTACIONIT DHE
PUBLIKIMIT TË REZULTATEVE

II.1 TË PËRGJITHSHME

Procesi i inventarizimit, mjetet e nevojshme

Procesi i inventarizimit në terren i llojeve të faunës së egër objekt gjuetie, është një proces i rëndësishëm dhe gjatë të cilit kërkohet zbatimi me përpikëri i metodikave të inventarizimit. Njohja e cilësisë dhe dinamikës së popullatave natyrore është një element vendimtar për inventarizimin e tyre. Vështirësitë teknike dhe angazhimi i nevojshëm për të arritur këta objektiva, mund të jenë shumë të ndryshueshme në varësi të karakteristikave biologjike të çdo lloji dhe kushteve mjedisore në të cilin ata veprojnë. Metodika e inventarizimit na bën që të njihemi me numrin e llojeve të faunës së egër në një vend të caktuar në një kohë të caktuar.

Materialet bazë gjatë procesit të inventarizimit janë: dylbitë, skadat e regjistrimit, teleskopët dhe hartat e zonës.

Vlerësimi i numrit të popullatave duhet të jetë një pjesë integrale e çdo programi monitorimi. Është e rëndësishme që të përdoret një metodologji e tillë që lejon regjistrimin e sa më shumë pikave në një interval kohe të caktuar, duke bërë të mundur mbledhjen e të dhënave në sa më shumë pika të pavarura. Statistikisht, është më mirë të regjistrohen pesë pika të ndryshme në një interval kohor 10-ditor, sesa të numërohet e njëjta pikë pesë herë. Sa më larg të jenë pikat nga



njëra-tjetra, aq më shumë ka të ngjarë që të dhënat të mund të ekstrapolohen në një rajon më të gjerë.

Për ato lloje që janë të listuara si lloje objekt gjuetie në Shqipëri, por që nuk janë të regjistruara si lloje të riprodhueshme, sigurohet vetëm statusi aktual dhe një shënim. Megjithatë, të gjitha këto lloje në fakt dimërojnë në Shqipëri apo shtegtojnë përmes vendit dhe për këtë arsye këto lloje duhet të monitorohen.

Intervalet kohore të rekomanduara për regjistrimet specifike të llojeve janë shprehur si dhjetëditëshe, domethënë dhjetëditëshi i parë i muajit shënohet me (B), dhjetëditëshi i dytë i muajit shënohet me (M) dhjetëditëshi i tretë i

muajit shënohet me (E). Pasqyrimi i shkurtuar i dhjetëditëshit shoqërohet më pas me numrin e muajit përkatës.

Shembull:

“B5” tregon dhjetëditëshin e parë të muajit të pestë (muaji maj), që do të thotë nga data 1 deri më 10 maj, “M6” tregon dhjetëditëshin e dytë të muajit qershor që do të thotë nga 11 deri më 20 qershor, “E7”, tregon dhjetëditëshin në fund të korrikut që do të thotë nga data 21 deri ditën e fundit të muajit) etj.

Intervalet kohore për regjistrimin e llojeve të veçanta janë përshkruar në një tabelë përmbledhëse në fund të numërimit për secilin lloj.

Shkurt			Mars			Prill			Maj			Qershor			Korrik			Gusht		
B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E
												(1)	(2)	-	(3)	(4)				

Intervalet kohore për regjistrimet specifike të llojeve, gjithashtu, duhet të marrin në konsideratë dallimet rajonale në lidhje me klimën dhe topografinë. Për shembull, gjatësia e sezonit të riprodhimit ndryshon në mënyrë të konsiderueshme midis ultësirave dhe zonave malore.

Për këtë qëllim, është thelbësore një përshtatje e intervaleve kohore për censusin (regjistrimin) mbi riprodhimin e shpendëve në Shqipëri bazuar në fenologjinë e popullatave respektive të tyre.

Megjithatë, sequenca fenologjike e shumicës së llojeve të shpendëve është shumë e ngjashme midis rajoneve gjeografike dhe variacioni i madh në fenologji ndërmjet rajoneve gjeografike ndodh për shkak të një ndryshimi në rikthimin e zonave të riprodhimit. Me fjalë të tjera, nëse koha e ardhjes së një lloji është e njohur për një zonë të caktuar gjeografike në Shqipëri (apo kudo tjetër), hapat e mëposhtëm të fenologjisë së riprodhimit (dhe në përputhje me intervalet e rekomanduara kohore për regjistrimet specifike të llojeve) mundet, të paktën përparësisht, të deduktohen nga informatat e ofruara në kapitujt specifikë të llojeve në vijim.

Transektet

Transektet janë shumë të ngjashme me pikat e numërimit, por vëzhguesi në këtë rast regjistron të gjitha llojet që ka parë ose dëgjuar, ndërsa përshkon çdo seksion të transektit përgjatë seksioneve të tij. Çdo seksion është njësi e matjes dhe mund të jetë i gjatë 100 m ose më shumë (në varësi të llojit që

inventarizohet). Kjo metodë rekomandohet më mirë për terrene shumë të hapura, ku vëzhguesi mund t'i kushtojë vëmendjen e tij të plotë të llojet.

Në këtë metodë vëzhguesi duhet të përpiqet të mbulojë një sasi të caktuar të terrenit në një sasi të caktuar të kohës, p.sh., 100 m në dhjetë minuta.

Regjistrimi i të dhënave dhe publikimi i rezultateve

Në përfundim të procesit, të dhënat e inventarizimit që sigurohen/merren nga çdo zonë gjuetie, dërgohen në drejtorinë përgjegjëse për biodiversitetin në Ministrinë e Mjedisit, e cila i pasqyron ato në regjistrin përkatës hartuar sipas skedës paraqitur në fund të udhëzimit dhe i publikon në faqen zyrtare të ministrisë.

II.2 PËRSHKRIMI I PROCESIT

II.2.1 Përshkrimet e metodave të inventarizimit dhe të regjistrimit për llojet e rosave

Përshkrimet e metodave të regjistrimit për llojet e rosave përmbledhin të shtatë llojet e rosave të listuara në VKM nr. 546, datë 7.7.2010, “Për miratimin e listës së llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie”.

Inventarizimi i rosave bëhet nëpërmjet numërimit të foleve, çifteve dhe individëve, të cilët janë prezentë në zonë.

Inventarizimi në periudhën joriprodhuese

Realizimi i këtij lloji inventarizimi mund të kryhet nëpërmjet metodave të mëposhtme:



a) Panoramike, ku inventarizohen të gjithë shpendët, të cilët janë të pranishëm;

b) Panoramike, ku kryhet numërimi i llojeve, të cilat janë në sasi më të madhe në numër;

c) Panoramike, ku kryhet kërkimi e numërimi i llojeve, të cilët janë të pakët në numër.

Në inventarizimin e plotë të zonës duhet pasur parasysh edhe kufiri i zonës që po analizohet (si kufiri i bimësisë, ndërtesat etj.), i cili jep të dhëna të vlefshme në zonat e ndryshme të vëzhgimit.

Vëzhguesi/inventarizuesi kërkohet që të ketë eksperiencë dhe të tregojë kujdes në identifikimin e llojeve dhe të ketë njohuri të mira për biologjinë e llojit. Zona duhet kontrolluar disa herë për të verifikuar mirë prezencën e rosave të cilat zhyten në ujë për t'u ushqyer me bimë nënujore.

Mënyra e identifikimit konsiston në njohjen e mirë të fenotipit të çdo rose, dallimin e mirë të sekseve, gjithashtu, edhe zërin e tyre, të cilat mund të jenë këngë territoriale ose të kontaktit.

Teknikat e inventarizimit variojnë sipas numrit të llojit dhe zonës ku do të kryhet inventarizimi. Vështirësia për të inventarizuar është në rastet kur grupi i rosave është shumë i madh, kur rritet distanca e vëzhgimit dhe kur individët janë në fluturim ose në lëvizje.

Rreziku për të numëruar më shumë individë është kur kemi prezencën e një numri relativisht të vogël të rosave, kur kemi individë të cilët kanë dimensione të mëdha, si dhe kur kemi individë të cilët kanë pendë të ngjashme me njëra-tjetrën;

Rreziku për të numëruar më pak individë është në rastet e pranisë së një numri të madh individësh, në individë të cilët kanë dimensione të vogla, si dhe në individë të cilët kanë pendë uniforme.

Inventarizimi në grupet mikse, mund të bëhet me radhë, duke filluar me një lloj të caktuar (Psh. bajzat) e më pas llojet me radhë.

Inventarizimi i individëve në kohën e riprodhimit mund të kryhet nëpërmjet:

a) Numërimit të individëve të cilët folezojnë në koloni

b) Numërimit të individëve të cilët nuk folezojnë në koloni

c) Numërimit të foleve koloniale.

Metodika konsiston në hyrjen në zonën e riprodhimit për të numëruar kolonitë. Efektet

negative duhen vlerësuar, sepse ndërhyrja mund të ndikojë te rezultati i riprodhimit. Si rregull është që kolonitë të mos ngacmohen dhe si të tilla duhet të minimizohen vizitat.

Në disa raste është mirë që përveç çifteve që folezojnë të mblidhen të dhëna edhe për parametrat riprodhues (si numrin e vezëve, numrin e zogjve të çelur, gjithashtu, edhe vlerësimin e grabitjes së vezëve nga ana e grabitqarëve).

Nga ana praktike është mirë që inventarizimi të bëhet i ndarë për rosat që folezojnë në grup në Shqipëri nga ato që nuk folezojnë në grup, si kuqlla.

II.2.2 Përshkrimet e metodave të inventarizimit dhe të regjistrimit për avifaunën

Përshkrimi i metodave të regjistrimit për llojet e avifaunës përmbledh llojet thëllëzë e malit dhe shkurtë, si dy lloje të listuara në VKM nr. 546, datë 7.7.2010, "Për miratimin e listës së llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie".

Koha më e mirë për numërim gjatë sezonit të mbarështimit është zakonisht midis orës 05:00–09:00 në mëngjes. Në shumicën e rasteve nuk mund të bëhet numërim pas orës 10:00 në mëngjes. Përrjashtime mund të jetë në periudhën jashtë sezonit të riprodhimit. Është më mirë të fillohet brenda 15 minutave pas lindjes së diellit. Ekzaminimi i të dhënave pilot është mënyra më e mirë për të përcaktuar se kur normat e numërimit janë më të qëndrueshme. Në përgjithësi, periudha midis lindjes së diellit 3–4 orët në vijim është zakonisht relativisht e qëndrueshme për kryerjen e procesit të vrojtimit dhe numërimit. Për shumicën e llojeve, periudha ndërmjet agimit (dritës së parë) dhe lindjes së diellit, ka numrin dhe shkallën e shpendëve që këndojnë është disi më e lartë se në pjesën tjetër të mëngjesit. Për krahasueshmërisë maksimale në mundësinë e zbulimit për lloje midis pikave, është më i mirë të fillohet me lindjen e diellit se sa në të gdhirë.

Periudha e numërimit dhe numri i ekspeditave në terren për regjistrim

Numërimi gjatë sezonit të riprodhimit duhet kryer gjatë periudhës kur identifikimi i llojeve është më i qëndrueshëm. Brenda sezonit të riprodhimit, muajt maj-qershor dhe java e parë e korrikut janë më të përshtatshme për numërimin e shumicës së shpendëve këngëtarë.



Për shkak të dallimeve në fenologjinë e mbërritjes dhe folezimit, ekspedita duhet të mbulojë një periudhë të gjatë të mjaftueshme për të siguruar që çdo lloj është lehtësisht i dukshëm në të paktën tri ekspedita. Duhet të kryhen 10 ekspedita në një shpërndarje normale të këtyre shpendëve. Nëse dendësia e shpendëve është shumë e lartë dhe periudha e folezimit e komunitetit është e gjatë, rekomandohen 12 ekspedita. Ekspeditat duhet të jenë të shpërndara në mënyrë të barabartë gjatë periudhës së regjistrimit. Më pak ekspedita mund të mjaftojnë në habitate të hapura, ku densiteti i shpendëve është zakonisht më i ulët se në pyje ose ku sezoni është më i shkurtër.

Moti

Shpendët nuk duhen numëruar kur shiu apo era ndërhyjnë me intensitetin ose dëgjueshmërinë e tingujve të shpendëve, kur mjegulla ose shiu ndërhyjnë me vizibilitetin ose kur moti i ftohtë ndërpret aktivitetin e shpendëve këngëtarë.

Pikat e numërimit

Sugjerohen dy nivele të numërimit:

- Pika numërimi ekstensive konsistojnë në një seri pikash numërimi, të vendosura maksimumi 250 m larg njëra-tjetrës, kryesisht në rrugë dhe shtigje brenda një rajoni;
- Pika numërimi intensive, të cilat janë të vendosura në një sistem rrjeti ose në një plot për kërkim folesh.

Qëllimi

Në shumë vende, pikat e numërimit janë metoda kryesore në monitorimin e ndryshimeve të popullatave të shpendëve tokësorë. Me metodën e numërimit me pika është e mundur të studiohen ndryshimet vjetore të popullatave të shpendëve në pika fikse, dallimet në përbërjen e llojeve midis habitateve dhe modelet e densitetit të llojeve. Metoda me pika numërimi është ndoshta metoda më efikase dhe të dhëna të pasura të numërimit të shpendëve. Kjo është metodë e preferuar në habitatet pyjore apo terren të vështirë. Pikat e numërimit konsistojnë në një vëzhgues në këmbë në një vend dhe që regjistron të gjithë shpendët e parë apo të dëgjuar në një distancë të caktuar ose në një distancë të pakufizuar. Kjo metodë mund të zbatohet një ose më shumë herë në një pikë të caktuar.

Përsëritja e numërimit

Në përgjithësi, një stacion duhet të kampionohet vetëm një herë çdo sezon.

Numërimet mund të përsëriten nëse qëllimi është vlerësimi shumë i saktë i popullatës së shpendëve, në pika të veçanta të caktuara, të tilla si një zonë e vogël e një habitati të rrallë ligatinor.

Koha e regjistrimit të çdo rruge duhet të mbahet konstante nga viti në vit; ajo nuk duhet të ndryshojë me më shumë se shtatë ditë nga data e numërimit të parë. Nëse fenologjia e pranverës ndryshon, atëherë data mund të ndryshohet. Fillimi i numërimit nuk duhet të ndryshojë me më shumë se 30 minuta nga ai i vitit të parë. Nëse është e mundur, i njëjti vëzhgues duhet të regjistrojë çdo vit në të njëjtat pika.

II.2.3 Përshkrimet e metodave të inventarizimit dhe të regjistrimit për shpendët e tjerë

Përshkrimet e metodave të regjistrimit në këtë nënçështje përmbledhin llojet bajzë, shapka e ujit, pëllumbi i egër, turtulli dhe lauresha, të listuara në VKM nr. 546, datë 7.7.2010, “Për miratimin e listës së llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie”.

Në ndryshim nga llojet e rosave dhe avifaunës dhe, përveç sa thuhet më lart për to, për këto lloje të tjera mund të procedohet gjatë inventarizimit edhe nëpërmjet unazimit.

Unazat janë përbërje e lehtë metali në të cilën shënohet me iniciale vendi ku është kapur. Metoda përdoret duke i zënë me rrjeta nëpërmjet verbimit momental, me drita të forta prozhektori ose në qarqe. Shpendët mbledhen në thasë ku matet gjatësia, pesha, markohen te këmba me unaza dhe më pas lëshohen të lirë. Rëndësia e këtij procesi është tepër e madhe, sepse mundëson numërimin e saktë të popullatës, mundëson vlerësimin statistikor të popullatës nëpërmjet teknikës së përsëritjes, zënie dhe lënie. Gjithashtu, mundëson edhe identifikimin e trajektoreve të lëvizjeve migratore.

II.2.4 Përshkrimet e metodave të inventarizimit dhe të regjistrimit për gjitarët

Përshkrimi i metodave të regjistrimit për llojet e gjitarëve përmbledh të dy llojet, lepur dhe dhelprë, të listuara në VKM nr. 546, datë 7.7.2010, “Për miratimin e listës së llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie”.

Në ndryshim nga llojet më sipër dhe krahas sa thuhet më lart, për këto dy lloje në këtë nënçështje mund të procedohet gjatë



inventarizimit me metoda të tjera indirekte, siç janë numërimi me prozhektor, numërimi i strofullave të riprodhimit dhe markimet me urinë. Megjithatë, të gjitha këto kanë edhe kufizimet e tyre dhe janë më pak të rekomanduara për dhelpren.

II.3 TEKNIKAT DHE METODAT QË PËRDOREN PËR INVENTARIZIM (SIPAS LLOJEVE)

II.3.1 Kuqlla qafëgjelbër (*Anas platyrhynchos*)

Statusi

Trendi i popullsisë në Evropë: në rritje të moderuar.

Të listuara në Listën e Kuqe Evropiane të Shpendëve si LC Red Evropian – rrezik i ulët.

Habitati

I pranishëm në pothuajse të gjitha habitatet me pellgje të ndenjura apo me rrjedhje të ujit plotësisht të lira nga vegetacioni, liqene, pellgje të mëdha dhe të vogla, moçale, kanale kullotash, lumenj dhe përrenj, si dhe organizma hidrikë urbanë, për shembull, pellgje në parqe.

Biologjia riprodhuese

Riprodhohet kryesisht përdhe; folezon në vende të ndryshme p.sh. në kallamishte, bimësi bregore, gardhe, gëmusha, livadhe, fusha, si edhe në pemë dhe në ndërtesa, mundësisht pranë mjediseve ujore, por ndonjëherë 3 km larg nga uji;

Riprodhues i vetmuar; monogam sezonal (edhe në mënyrë të përhershme monogam), inkubon njëherë në vit, lëshon: 7–13 vezë, periudha e riprodhimit: 24–32 ditë, puplohet në moshën e 50–60 ditëve; mashkulli♂ mund çiftohet me femra♀ të ndryshme, vendi i folezimit zgjidhet nga mashkulli♂ dhe femra♀, folenë e ndërton femra♀ dhe e vetme rrit dhe drejton të vegjlit.

Fenologjia

Censusi

Shkurt			Mars			Prill			Maj			Qershor			Korrik			Gusht		
B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E
				(1)	(2)	(3)		(4)												

Shënime

Shpendët e çiftuar, ndryshojnë dukshëm në sjellje nga shpendët e paçiftuar. Ata rrinë më afër njëri-tjetrit, më shpesh dhe më gjatë bashkë, krabasuar me tufën e shpendëve të paçiftuar. Ata i mbajnë individët e tjerë në distancë duke i kërcënuar ose pickuar. Çiftet territoriale dhe femrat ♀ kanë

Shtegtues i distancave të shkurtra ose rezident; në rastet kur çiftet shtegtuese mbërrijnë në vendin e riprodhimit, kryhet ndarja e territoreve e cila fillon që nga 10-ditëshi i parë i muajit janar e tutje, çiftimi i individëve është realizuar më parë, që në fund të vjeshtës; shtegtimi pranveror vazhdon deri në fillim të prillit ku piku i shtegtimit është në fillim të marsit deri në fund të tij; femra mund të depozitojë vezët nga fillimi i janarit deri në fund të korrikut, periudha kryesore e inkubimit është shkurti. Meshkujt♂ braktisin femrën♀ përafërsisht një javë pas fillimit të riprodhimit.

Aktiv gjatë ditës dhe natës.

Metodat e censurit (regjistrimit)

Numërimi në territor i çifteve/individëve të izoluar, meshkujve♂, të cilët ruajnë territorin, i meshkujve♂ që joshin dhe meshkujve që drejtojnë të vegjlit.

Datat:

1. Fund i shkurtit (numërimi i çifteve dhe i individëve);

2. Fillimi i muajit mars (numërimi i çifteve, numërimi i meshkujve të veçuar që ruajnë territorin dhe femrave♀ të ndrojtura);

3. Mesi i marsit deri në fund të tij (numërimi i meshkujve♂ të veçuar që ruajnë territorin dhe femrave♀ të ndrojtura, numërimi i meshkujve♂ që udhëzojnë të vegjlit), fakultativ;

4. Mesi i prillit deri në fund të tij (numërimi i femrave♀ që drejtojnë të vegjlit ose meshkujve♂ që kryejnë paradën).

Koha më e mirë për të numëruar: Numërimi i çifteve gjatë ditës, ndërsa femra♀ me zogj kryesisht gjatë muzgut.

Regjistrimi i riprodhimit: Veçanërisht nëpërmjet numërimit të femrave që drejtojnë të vegjlit.

një sjellje karakteristike në fluturim: fluturim notues dhe kthim i menjëhershëm në të njëjtin trup ujqor apo pjesë e trupit ujqor. Vëzhgimi i ruajtjes së partnerit (mashkulli♂ ruan femrën♀, kur largohet nga foleja – vëzhgimi më i mirë në mbrëmje), mund të vlerësohet si një tregues për riprodhimin. Diferencimi i shpendëve joriprodhues nga



shpendët riprodhues është i mundur vetëm duke i vëzhguar tufat shumë herë dhe me kujdes të veçantë. Në zonat me popullsi të mëdha të riprodhimit (ligatinat bregdetare, liqenet dhe pellgjet me dendësi të lartë të vegetacionit), dallimi i popullsisë riprodhuese është tepër i vështirë, dhe kërkon vëmendje të madhe. Në zonat me dukshmëri të ulët nga toka rekomandohet edhe përdorimi i një varke.

II.3.2 Rosa e përhime (*Mareca strepera*)

Statusi

Trendi i popullsisë në Evropë: i panjohur.

Të listuara në Listën e Kuqe Evropiane të Shpendëve si LC Red European – shqetësim i ulët.

Habitati

Kryesisht preferon sipërfaqet të cekëta me ujë të ndenjtur mezo deri në eutrofikë, zakonisht liqene dhe pellgje, por, gjithashtu, edhe sipërfaqe ujore me rrjedhje të ngadalta me barishte.

Biologjia riprodhuese

Shpend që riprodhohet përdhe; folezon kryesisht në sipërfaqe të thata, me vegetacion bimor, zakonisht pranë sipërfaqeve ujore; riprodhues i vetmuar, por përqendrohet në afërsi të kolonive të mundshme të pulëbardhave dhe të dallëndysheve të detit; monogam sezonal, megjithatë është vëzhguar prirja drejt monogamisë në mënyrë të përhershme; inkubon një herë në vit, lëshon: 8–12 vezë, periudha e riprodhimit: 24–26 ditë, puplohet në moshën e 45–50 ditë; femra♀ rrit dhe drejton të vegjlit.

Fenologjia

Shtegtues i distancave të shkurtra; krijimi i çiftit ndodh në fund të verës deri në vjeshtë, fluturimet ndjekëse dhe paradat në not ndodhin nga gushti deri në maj (pjesërisht në zonat e dimërimit); në rastet kur çiftet mbërrijnë në vendin e riprodhimit krijimi i territoreve të

riprodhimit ndodh nga mesi i shkurtit deri në fund të marsit. Shtegtimi pranveror ndodh nga fillimi i janarit deri në fund të prillit dhe piku i migrimin nga fillimi i shkurtit deri në mes të marsit. Lëshon vezët nga fund i marsit deri në mes të qershorit, periudha kryesore e çeljes së vezëve behet nga fund i prillit deri në fillim të majit. Mashkulli ♂ braktis femrën♀ në mes të sezonit të riprodhimit.

Aktiv gjatë ditës dhe natës, gjatë periudhës së riprodhimit aktiv kryesisht në muzg.

Metodat e censurit

Numërimi në territor i çifteve/individëve të izoluar, meshkujve ♂ që ruajnë territorin, i femrave ♀ që joshin dhe femrave ♀ që drejtojnë të vegjlit.

Datat:

1) Fund i marsit (numërimi i çifteve/individëve);

2) Fillimi i prillit (numërimi i çifteve, numërimi i meshkujve ♂ të veçuar që ruajnë territorin dhe i femrave ♀ përkatëse);

3) Mesi i prillit deri në fund të majit (numërimi i çifteve, numërimi i meshkujve♂ të veçuar që ruajnë territorin dhe i femrave ♀ përkatëse), fakultativ;

4) Fillimi i majit deri në fund të majit (numërimi i femrave ♀ që drejtojnë të vegjlit ose i femrave ♀ që joshin).

Koha më e mirë për të numëruar: Numërohen çiftet gjatë ditës, femrat ♀ me zogj sidomos gjatë muzgut, por, gjithashtu, edhe në orët e para të mëngjesit.

Regjistrimi i riprodhimit: Veçanërisht, nëpërmjet numërimit të femrave♀ që drejtojnë të vegjlit, joshin ose paralajmërojnë.

Censuri

Shkurt			Mars			Prill			Maj			Qershor			Korrik			Gusht		
B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E
					(1)	(2)	(3)		(4)											

Shënime

Shpendët e çiftuar, ndryshojnë dukshëm në sjellje nga shpendët e paçiftuar. Ata rrinë më afër njëri-tjetrit, më shpesh dhe më gjatë bashkë, krabasuar me tufën e shpendëve të paçiftuar. Ata i mbajnë individët e tjerë në distancë duke i kërcënuar ose përkulur. Çiftet territoriale dhe femrat ♀ kanë një sjellje karakteristike në fluturim: fluturim notues dhe

kthim i menjëhershëm në të njëjtin trup ujqor apo pjesë e trupit ujqor. Vëzhgimi i ruajtjes së partnerit (mashkulli♂ ruan femrën ♀, kur largohet nga foleja – vëzhgimi më i mirë në mbrëmje), mund të vlerësohet si një tregues për riprodhimin.



II.3.3 Rosa bishtgjelë (*Anas acuta*)

Statusi

Nuk ka të dhëna riprodhimi në Shqipëri.

Trendi i popullsisë në Evropë: i panjohur.

Të listuara në Listën e Kuqe Evropiane të Shpendëve, si LC Red Evropan – shqetësim i ulët.

Bishtgjeta aktualisht nuk riprodhohet në Shqipëri, një monitorim i riprodhimit të shpendëve të këtij lloji nuk zbatohet. Të dhënat më të afërta të riprodhimit janë nga veri-lindja e Kroacisë, duke treguar se të dhënat e ardhshme të riprodhimit të këtij lloji nga Shqipëria mund të jenë të mundura. Megjithatë, dimërimi dhe shtegtimi i shpendëve ndodhin në Shqipëri dhe për këtë arsye duhet të inventarizohet.

Habitati

Aktualisht, kryesisht popullon ligatina bregdetare, në brendësi të vendeve të hapura, p.sh. liqene, moçale.

Biologjia riprodhuese

Shpend që riprodhohet përdhe, folezon mbi shtresë të thatë, i fshehur mirë në mesin e vegjetacionit, zakonisht pranë sipërfaqeve ujore, por herë pas here edhe larg, p.sh. në livadhe, mundësisht në afërsi të kolonive të shpendëve detarë, në kullotat bregdetare, gjithashtu, edhe në livadhet e kultivuara në mënyrë jointensive. Riprodhues i vetmuar monogam sezonal. Inkubon një herë në vit, lëshon: 7–11 vezë, periudha e riprodhimit: 22–24 ditë. Të vegjlit puplohen në moshën e 40–45 ditëve; mashkulli ♂ i çiftuar, çiftohet edhe me femra ♀ të ndryshme, femra ♀ ndërton follenë, rrit dhe drejton të vegjlit.

Censusi

Shkurt			Mars			Prill			Maj			Qershor			Korrik			Gusht		
B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E
								(1)	(2)	(3)		(4)								

Shënime

Shpendët e çiftuar, ndryshojnë dukshëm në sjellje nga shpendët e paçiftuar. Ata rrinë më afër njëri-tjetrit, më shpesh dhe më gjatë bashkë, krabasuar me tuftën e shpendëve të paçiftuar. Ata i mbajnë individët e tjerë në distancë duke i kërcënuar ose pickuar. Çiftet territoriale dhe femrat ♀ kanë një sjellje karakteristike në fluturim: fluturim notues dhe kthim i menjëhershëm në të njëjtin trup ujqor apo pjesë e trupit ujqor. Vëzhgimi i ruajtjes së partnerit (mashkulli ♂ ruan femrën ♀, kur largohet nga foleja – vëzhgimi më i mirë

Fenologjia

Shtegtues i distancave të mesme dhe të gjata; parada dhe lidhja e çiftit ndodh në zonën e dimërimit; në rastet kur çiftet mbërrijnë në vendin e riprodhimit krijimi i territoreve të riprodhimit ndodh nga mesi i shkurtit deri në fillim të prillit. Migrimi pranveror ndodh nga mesi i shkurtit deri në mes të majit dhe piku i migrimit nga mesi i marsit deri në fund të prillit. Lëshon vezët normalisht nga mesi–fundi i prillit, periudha kryesore e çeljes së vezëve është në maj. Mashkulli ♂ braktis femrën ♀ rreth një javë mbas fillimit të riprodhimit.

Aktiv gjatë ditës dhe gjatë natës, të ushqyerit kryesisht bëhet gjatë natës.

Metodat e censusit

Numërimi në territor i çifteve/individëve të izoluar, meshkujve ♂ që ruajnë territorin, femrave ♀ të ndrojtura, si dhe femrave ♀ që drejtojnë të vegjlit.

Datat:

1. Fillimi i prillit (numërimi i çifteve/individëve);
2. Fillimi i majit (numërimi i çifteve, numërimi i meshkujve ♂ të veçuar që ruajnë territorin dhe i femrave ♀ të ndrojtura);

3. Mesi i majit deri në fund të muajit (numërimi i çifteve, numërimi i meshkujve ♂ të veçuar që ruajnë territorin dhe i femrave ♀ të ndrojtura).

Koha më e mirë për të numëruar: Numërimi i çiftet gjatë ditës, femrave ♀ me zogj sidomos gjatë muzgut, dhe në orët e para të mëngjesit.

Regjistrimi i riprodhimit: Veçanërisht nëpërmjet numërimit të femrave ♀ që drejtojnë të vegjlit, joshin ose paralajmërojnë.

në mbremje), mund të vlerësohet si një tregues për riprodhimin.

II.3.4 Sqepluga (*Spatula clypeata*)

Statusi

Të dhënat e riprodhimit në Shqipëri.

Trendi i popullsisë në Evropë: në rënie.

Të listuara në Listën e Kuqe Evropiane të Shpendëve, si LC Red Evropan – rrezik i ulët.



Habitati

Trupat sipërfaqësorë ujorë eutrofikë, kryesisht me kallamishte dhe shqirë *Carex spp.*, liqene të cekëta, pellgje, moçale me sipërfaqe të vogla të hapura ujore (nganjëherë i rrethuar nga pemë), gjithashtu, edhe sipërfaqet ujore artificiale fushat e përmbytura etj.

Biologjia riprodhuese

Shpend që riprodhohet përdhe. Folezon kryesisht në zonat me filtrime të sipërfaqeve ujore të rrethuara nga të gjitha anët me ujë, megjithatë nganjëherë edhe larg nga uji (p.sh. në livadhe), rrallë në pemë shelgu dhe shkurre; monogam sezonal; inkubon një herë në vit; lëshon: 8–12 vezë, periudha e riprodhimit: 21–25 ditë, të vegjlit mbulohen me pupla në moshën e 40–45 ditë; femra ♀ ndërton folenë, riprodhohet dhe drejton të vegjlit.

Fenologjia

Shtegtues i distancave të gjata. Parada e meshkujve ♂ kryhet nga mesi i dimrit deri në pranverë, lidhja e çiftit ndodh në periudhën e dimrit, por edhe në kohën e riprodhimit. Kur çiftet mbërrijnë në vendin e riprodhimit kryhet krijimi i territoreve të riprodhimit i cili ndodh nga fillim të marsit në deri në fund të muajit; shtegtimi në pranverë ndodh deri në fillim të majit, femra ♀

depoziton vezët nga fillim i prillit në deri në fund të qershorit, periudha e çeljes së vezëve nga fillimi i majit në fillim të qershorit; Meshkujt ♂ braktisin femrat ♀ 1–2 javë pas fillimit të riprodhimit.

Aktiv gjatë ditës dhe gjatë natës, të ushqyerit kryhet kryesisht gjatë natës.

Metodat e censurit

Numërimi në territor i çifteve/individëve të izoluar, i meshkujve ♂ që ruajnë territorin, i femrave ♀ të ndrojtura, si dhe i femrave ♀ që drejtojnë të vegjlit.

Datat:

1. Fund i prillit (numërimi i çifteve);
 2. Mesi i majit (numërimi i çifteve, numërimi i individëve, meshkujve ♂ që ruajnë territorin);
 3. Fund i majit deri në fillim të qershorit numërimi i çifteve, numërimi i meshkujve ♂ të veçuar që ruajnë territorin dhe i femrave ♀ të ndrojtura dhe të femrave ♀ që drejtojnë të vegjlit, fakultativ;
 4. Mesi i qershorit deri në fillim të korrikut (numërimi i femrave ♀ që drejtojnë të vegjlit).
- Koha më e mirë për të numëruar: Numërimi i çiftet gjatë ditës, femrat ♀ me zogj sidomos gjatë muzgut, dhe në orët e para të mëngjesit.
- Regjistrimi i riprodhimit: Veçanërisht nëpërmjet numërimit të femrave ♀ që drejtojnë të vegjlit.

Censusi

Shkurt			Mars			Prill			Maj			Qershor			Korrik			Gusht		
B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E
								(1)		(2)	(3)		(4)							

Shënime

Shpendët e çiftuar, ndryshojnë dukshëm në sjellje nga shpendët e paçiftuar. Ata rrinë më afër njëri-tjetrit, më shpesh dhe më gjatë bashkë, krabasuar me tufën e shpendëve të paçiftuar. Ata i mbajnë individët e tjerë në distancë duke i kërcënuar ose pickuar. Çiftet territoriale dhe femrat ♀ kanë një sjellje karakteristike në fluturim: fluturim notues dhe këhim i menjëhershëm në të njëjtin trup ujor apo pjesë e trupit ujor. Vëzhgimi i ruajtjes së partnerit (mashkulli ♂ ruan femrën ♀, kur largohet nga foleja – vëzhgimi më i mirë në mbrëmje), mund të vlerësohet si një tregues për riprodhimin.

II.3.5 Kryekuqja e madhe (*Mareca penelope*)

Statusi

Nuk ka të dhëna riprodhimi në Shqipëri
Trendi i popullsisë në Evropë: në rënie.

Të listuara në Listën e Kuqe Evropiane të

Shpendëve, si LC Red European – shqetësim i ulët.

Meqenëse kryekuqja e madhe aktualisht nuk riprodhohet në Shqipëri edhe monitorimi i riprodhimit të individëve të kësaj specie nuk zbatohet. Të dhënat më të afërta të riprodhimit janë nga veri-lindja e Bjellorusisë.

Megjithatë, dimërimi dhe shtegtimi i shpendëve ndodh në Shqipëri dhe për këtë arsye duhet, gjithashtu, të inventarizohet.

Inventarizimi i llojit kryhet në të njëjtën metodikë sikurse llojet e tjerë që nuk riprodhohen në vendin tonë (si p.sh., grilla, bishtëgjela).

II.3.6 Rosa kërre (*Anas crecca*)

Statusi

Nuk ka të dhëna riprodhimi në Shqipëri.



Trendi i popullsisë në Evropë: i panjohur.

Të listuara në Listën e Kuqe Evropiane të Shpendëve, si LC Red Evrobian – shqetësim i ulët.

Grilla aktualisht nuk riprodhohet në Shqipëri. Megjithatë, dimërimi dhe shtegtimi i shpendëve ndodh në Shqipëri dhe për këtë arsye duhet, gjithashtu, të inventarizohet.

Habitati

Trupa ujqorë sipërfaqësorë të brendshëm, me bimësi të dendur bregore, kënetat, moçalet, pellgje moçalore të rrethuar me pyje; në livadhe me lagështi përgjatë kanaleve me vegetacion; madje edhe në pellgjet me peshq dhe liqene; zona me baltë të ekspozuara formojnë një habitat të rëndësishëm të riprodhimit (dhe të kërkimit të ushqimit).

Biologjia e riprodhimit

Riprodhohet përdhe, folezon në bimësi të dendur bregore ose nën shkurre kallamishte, kryesisht në afërsi të ngushtë me sipërfaqet ujore, por edhe në nënshtresa të thata ndonjëherë larg nga uji, në kullota bregdetare të lagura, si dhe në toka të kultivuara jointensivisht; riprodhues i vetmuar; monogam sezonal; inkubon një herë në vit; lëshon: 8–11 vezë, periudha e riprodhimit: 25–30 ditë; të vegjlit puplohen në moshën e 25–30 ditëve, femra ♀ ndërton folenë, riprodhohet dhe drejton të vegjlit.

Fenologjia

Shtegtues i distancave të shkurtra; në rastet kur çiftet mbërrijnë në vendin e riprodhimit, krijimi i

territoreve të riprodhimit ndodh nga fillimi i marsit në fillim të prillit; çiftohen herë pas here pas mbërritjes në vendet e riprodhimit, lidhja e çiftit kryhet në fund të dimrit, paradat ndodhin nga shtatori në qershor. Migrimi i pranverës ndodh nga mesi dhe fund i shkurtit deri në mes të majit.

Metodat e censurit

Numërimi në territor i çifteve/individëve të izoluar dhe meshkujve ♂ që ruajnë territorin dhe i femrave ♀ të ndrojtura, respektivisht numërimin e paradave dhe i femrave ♀ që drejtojnë të vegjlit.

Datat:

1. Fund i prillit deri në fillim të majit (numërimi i çifteve);
2. Mesi i majit (numërimi i çifteve dhe/ose numërimi i individëve, meshkujve ♂ që ruajnë territorin);
3. Fillimi i majit (numërimi i individëve, i meshkujve ♂ që ruajnë territorin dhe i femrave ♀ të ndrojtura, fakultativ);
4. Fillimi i qershorit deri në mes të korrikut (numërimi i femrave ♀ të ndrojtura, që drejtojnë të vegjlit ose i femrave ♀ që joshin).

Koha më e mirë për të numëruar: Numërimi çifteve gjatë ditës, të ardhurit rrotull në agim dhe në muzg. Femrat ♀ me të vegjlit sidomos gjatë muzgut.

Regjistrimi i riprodhimit: Veçanërisht nëpërmjet numërimit të femrave ♀ që drejtojnë të vegjlit, paralajmërojnë (që fluturojnë rreth një armiku të mundshëm).

Censuri

Shkurt			Mars			Prill			Maj			Qershor			Korrik			Gusht		
B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E
								(1)		(2)	(3)	(4)								

Shënime

Shpendët e çiftuar, ndryshojnë dukshëm në sjellje nga shpendët e paçiftuar. Ata rrinë më afër njëri-tjetrit, më shpesh dhe më gjatë bashkë, krabasuar me tufën e shpendëve të paçiftuar. Ata i mbajnë individët e tjerë në distancë duke i kërcënuar ose pickuar. Çiftet territoriale dhe femrat ♀ kanë një sjellje karakteristike në fluturim: fluturim notues dhe këhim i menjëhershëm në të njëjtin trup ujqor apo pjesë e trupit ujqor. Vëzhgimi i ruajtjes së partnerit (mashkulli ♂ ruan femrën ♀, kur largohet nga foleja – vëzhgimi më i mirë në mbrëmje), mund të vlerësohet si një tregues për riprodhimin.

Popullsia riprodhuese është e vështirë të vlerësohet në zonat e paarrtshme (pellgje dhe liqene me shumë bimësi). Në këtë rast janë të nevojshme së paku 4 seanca kampionimi në periudhën nga fillimi i prillit në fundi të qershorit. Në sipërfaqet e mëdha ujore, në zona të gjera dhe të fshehura, rekomandohet përdorimi i një varke. Pas mbërritjes në vendet e riprodhimit, shpendët mblidhen në tufa të vogla prej 10–20 individësh. Ata mund të çiftohen këtu. Fillimi i riprodhimit në këto habitate shpesh ndodh në fund të majit.



II.3.7 Marsatorja (*Spatula querquedula*)

Statusi

Të dhënat e riprodhimit në Shqipëri.

Trendi i popullsisë në Evropë: në rënie.

Të listuara në Listën e Kuqe Evropiane të Shpendëve, si LC Red Evropan – rrezik i ulët.

Habitati

Sipërfaqe ujorë eutrofikë në zona me bimësi ujore, liqene të cekëta, pellgje, në sipërfaqe ujore kanale etj.

Biologjia e riprodhimit

Riprodhohet përdhe, shpesh folezon në terren të thatë, foleja fshihet me kujdes mes vegjetacionit bregor ose kullësor, sidomos në afërsi të sipërfaqeve ujore, megjithatë, nganjëherë shumë më larg, për shembull, edhe në lëndina; monogam sezonal; riprodhohet një herë në vit; lëshon: 8–11 vezë; periudha e riprodhimit: 21–23 ditë; të vegjlit puplohen në moshën e 35–40 ditësh; femra ♀ rrit dhe drejton të vegjlit.

Fenologjia

Shtegtues i distancave të gjata. Parada dhe lidhja e çiftit ndodh në zonat e dimërimit, nga vjeshta deri në fund të pranverës; në rastet kur çiftet mbërrijnë në vendin e riprodhimit krijimi i territoreve të riprodhimit ndodh nga mesi i marsit në fillim të prillit. Migrimi i pranverës ndodh nga fillimi i marsit në mes të majit, në jug nga fillimi i shkurtit e në vazhdim. Piku i migrimit është nga fillimi i marsit deri në mes të

prillit. Vezët lëshohen në periudhën nga mesi i prillit deri në fillim të qershorit; periudha kryesore e çeljes është maji; mashkulli ♂ braktis femrën ♀ 1–2 javë mbas fillimit të riprodhimit.

Aktiv gjatë ditës dhe gjatë natës, kërkimi i ushqimit bëhet kryesisht gjatë natës.

Metodat e censusit

Inventarizimi në terren i çifteve/individëve të izoluar dhe meshkujve ♂ që ruajnë territorin dhe i femrave ♀ të ndrojtura, respektivisht numërimi i paradave dhe femrave ♀ që drejtojnë të vegjlit.

Datat:

1. Fillimi i prillit (numërimi i çifteve/individëve dhe meshkujve ♂ thirrës);

2. Fillimi i majit (numërimi i individëve, i meshkujve ♂ që ruajnë territorin dhe i femrave ♀ të ndrojtura);

3. Fillimi i majit në fund të muajit (numërimi i individëve, i meshkujve ♂ që ruajnë territorin dhe i femrave ♀ të ndrojtura; numërimi i femrave ♀, që drejtojnë të vegjlit ose i femrave ♀ që kryejnë paradën).

Koha më e mirë për të numëruar: Numërimi i çifteve gjatë ditës, të ardhurit rotull në agim dhe në muzg, i femrave ♀ me zogj sidomos gjatë muzgut.

Regjistrimi i riprodhimit: Veçanërisht nëpërmjet numërimit të femrave ♀ që drejtojnë të vegjlit ose paralajmërojnë.

Censusi

Shkurt			Mars			Prill			Maj			Qershor			Korrik			Gusht		
B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E
							(1)	(2)	(3)			(4)								

Shënime

Shpendët e çiftuar, ndryshojnë dukshëm në sjellje nga shpendët e paçiftuar. Ata rrinë më afër njëri-tjetrit, më shpesh dhe më gjatë bashkë, krahasuar me tufën e shpendëve të paçiftuar. Ata i mbajnë individët e tjerë në distancë duke i kërcënuar ose pickuar. Çiftet territoriale dhe femrat ♀ kanë një sjellje karakteristike në fluturim: fluturim notues dhe kthim i menjëhershëm në të njëjtin trup ujor apo pjesë e trupit ujor. Vëzhgimi i ruajtjes së partnerit (mashkulli ♂ ruan femrën ♀, kur largohet nga foleja – vëzhgimi më i mirë në mbrëmje), mund të vlerësohet si një tregues për riprodhimin.

Ka vështirësi vlerësimi për ligatinat bregdetare për shkak të densitetit të lartë të popullsisë. Këtu, shumë meshkuj ♂ të paçiftuar mund të ekspozojnë një fluturim ndjekës.

Informacion i rëndësishëm shtesë mund të mblidhet gjatë ekskursioneve të natës, sepse marsatorja shpesh thërret/ këndon gjatë natës.

II.3.8 Thëllëzë mali (*Alectoris graeca*)

Statusi

Ka të dhëna riprodhimi në Shqipëri, dyshohet një rënie e fortë që nga 1995.

Trendi i popullsisë në Evropë: në rënie.

Të listuara në Listën e Kuqe Evropiane të Shpendëve si NT Red Evropan – e kërcënuar.

Habitati

Shpatet e pjerrëta alpine dhe rripat subalpine. Preferon vendet e thata dhe me diell: me gurë apo shpatet shkëmbore (me rrugë të shkurtra arratisje),



të cilat janë të vështira për t'u parë me mozaikë terreni të hapur dhe bar të thatë dhe shkurre. Edhe në pyje të hapur, rrëpira me gurë të rrëzuar, shpatet e thata, vreshta etj.

Biologjia e riprodhimit

Riprodhohet përdhe, folezon në bazën e një peme apo shkëmbi, nën shkurre dhe barishte, duke mbuluar pjesërisht pamjen nga pjesët e varura të vegjetacionit apo shkëmbinj; çiftet janë sezonale dhe shpesh të përhershme, monogame; inkubon një herë në vit; lëshon: 9–14 vezë; periudha e riprodhimit: 24–26 ditë; femra ♀ riprodhohet dhe drejton të vegjlit; të vegjlit mbulohen mesatarisht me pupla në moshën e 20 ditëve, rriten për 50–60 ditë, familjet qëndrojnë së bashku për një periudhë më të gjatë kohore.

Fenologjia

Rezident, shtegtimi në ngritje sipas situatës të dëborës (shtegtimi dhe zona e riprodhimit mund të jenë deri në 9 km larg njëra-tjetrës), shtegtimi horizontal deri në 10 km, zonat e përhapjes natyrale të meshkujve ♂ mund të mbulojnë deri në 10–15 km, por janë shumë më të vogla në shumicën e rasteve; formimi i çifteve kryesisht nga fillimi i marsit deri në prill; lëshimi i vezëve në fillim të majit apo në fillim të qershorit; femra ♀ drejton të vegjlit shpesh shumë më lart se limiti i pyllit; të vegjlit puplohen nga mesi i korrikut e tutje.

Kryesisht aktiv gjatë muzgut dhe ditës, duke kënduar intensivisht deri në mëngjes dhe pastaj përsëri në pasdite.

Censusi

Shkurt			Mars			Prill			Maj			Qershor			Korrik			Gusht		
B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E
							(1)			-	(2)		(3)							

Shënime

Grupet që janë formuar gjatë vjeshtës/dimrit shpërndahen në pranverë, nga prill/maji e tutje shpesh në çifte; lidhje e fortë e çiftit në maj dhe qershor; shumë aktiv duke bërë thirrje në mëngjes dhe në mbrëmje, përdorimi i regjistrimit për të provuar praninë e specieve është i mundshëm gjatë gjithë vitit.

II.3.9 Shkurta (*Coturnix coturnix*)

Statusi

Të dhënat e riprodhimit në Shqipëri.

Trendi i popullsisë në Evropë: në rënie.

Të listuara në Listën e Kuqe Evropiane të Shpendëve, si LC – rrezik i ulët.

Metoda e parë

Kryesisht numërimi i meshkujve ♂ të shfaqur dhe femrave ♀ që drejtojnë të vegjlit, gjithashtu, edhe regjistrimi i një serie thirrjesh.

Datat:

1. Mesi i prillit deri nga fillimi i majit (regjistrimi i paradave dhe i serisë së thirrjeve);

2. Fund i majit, fillimi i qershorit (regjistrimi i paradave dhe i serisë së thirrjeve, si dhe i çifteve);

3. Mesi i qershorit, fundi i majit (regjistrimi i paradave, si dhe i çifteve).

Koha më e mirë e numërimit: Numërimi kryesisht gjatë muzgut, sidomos 1 orë para lindjes së diellit deri në 2 orë pas lindjes së diellit dhe 2 orë para perëndimit të diellit.

Metoda e dytë

Territori ku do të kryhet kampionimi zgjidhet midis 80–100 ha.

Numërimi kryhet në fund të verës: Fundi i gushtit deri në fillim të shtatorit (15.08–14.09).

Inventarizimi të jep të dhëna shumë të mira dhe për suksesin e riprodhimit.

Nevojiten 2 ose 3 persona dhe 2 qen gjuetie të stërvitur.

Inventarizimi mund të kryhet në të njëjtën kohë edhe me thëllëzën e fushës.

Kjo metodë inventarizimi nuk përcakton konsistencën, por jep të dhëna vetëm për rezultatit e riprodhimit.

Regjistrimet e riprodhimit: Veçanërisht nga regjistrimi i individëve/grupeve familjare; regjistrimi i foleve me lëkura të vezëve.

Habitati

Frekuenton tipa habitatesh të hapura: peizazhe bujqësore, tokë e pluguar pa shkurre ose pemë (p.sh., fushat e grurit të ri), livadhet, kullotat. Preferon rërë të ngrohtë dhe tokë moçalore, madje edhe baltë të thellë, në livadhe të vetmuar në mes të pyllit etj.

Biologjia e riprodhimit

Riprodhohet përdhe; foleja mbulohet gjithmonë me bimë, kullota; ka shumë të ngjarë të ketë një inkubim në vit, por është i mundshëm zëvendësimi i vezëve; lëshon: 7–14 vezë; periudha e riprodhimit: 18–20 ditë, të vegjlit mbulohen me pupla në



moshën e 19 ditëve, familjet shpërndahen kur zogjtë kanë mbushur 4–7 ditë; femra ♀ zgjedh vendin e riprodhimit, ndërton folenë, riprodhohet dhe i drejton vetë të vegjlit.

Fenologjia

Shtegtues i distancave të shkurtra apo të gjata, mbërritja në vendin e riprodhimit kryesisht mesi mesi i majit dhe fillimi i qershorit; krijimi i territoreve dhe lidhja e çifteve pas mbërritjes së tyre në vendin e riprodhimit, aktiviteti më i lartë i thirrjeve nga mesi majit në fillim të korrikut; lëshon vezët në periudhën nga mesi i majit në fund të gushtit; të vegjlit nga mesi i qershorit e tutje.

Aktiv gjatë ditës dhe natës.

Metodat e censurit

Pothuajse ekskluzivisht nga metodat akustike, kryesisht numërimi i thirrjeve të meshkujve ♂.

Censuri

Shkurt			Mars			Prill			Maj			Qershor			Korrik			Gusht		
B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E
												(1)	(2)	-	(3)	(4)				

Shënime

Shiu dhe moti i ftohtë varfërojnë veprimtarinë e thirrjes, pra regjistrimet duhet të kryhen mundësisht në mbremje të ngrohta. Regjistrimi mund të bëhet edhe në mëngjes, në vende të njëjta gjatë natës. Territorët mund të zhvendoset në mënyrë të konsiderueshme për arsye të aktiviteteve bujqësore apo kushteve të motit (thatësia).

Nuk ka lidhje të drejtpërdrejta midis numrit të thirrjeve të meshkujve ♂ dhe numrit të inkubimeve: Gjatë kohës të lëshimit të vezëve femra ♀ mund të ndryshojë disa partnerë (deri në katër) herë. Mashkulli ♂ ndalon të thërrasë kur çiftëzohet me femrën ♀. Lidhja e çiftit midis meshkujve ♂ dhe femrave ♀ përfundon pas fillimit të riprodhimit. Mashkulli ♂ dëbohet nga vendi i riprodhimit dhe më pas fillon të këndojë diku tjetër. Në zonat e mëdha të studimit regjistrimi duhet të kryhet me numërime të njëkohshme (1–2 persona për 1 km²).

II.3.10 Bajza (*Fulica atra*)

Statusi

Të dhënat e riprodhimit në Shqipëri.

Trendi i popullsisë në Evropë: në rritje të moderuar.

Të listuara në Listën e Kuqe Evropiane të Shpendëve, si NT– E i kërcënuar.

Habitati

Në pothuajse të gjitha llojet e peizazhit në

Datat:

1. Fillimi i qershorit (numërimin e thirrjeve të meshkujve ♂);

2. Mesi i qershorit (numërimin e thirrjeve të meshkujve ♂);

3. Fillimi i korrikut (numërimin e thirrjeve të meshkujve ♂);

4. Mesi i korrikut (numërimin e thirrjeve të meshkujve ♂) - regjistrimi në intervale dyjavore.

Koha më e mirë e numërimit: Numërimi kryhet një orë pas perëndimit të diellit dhe në agim.

Regjistrimet e riprodhimit: Veçanërisht nga regjistrimi i femrave ♀ që drejtojnë zogjtë (vëzhgimet e rastësishme).

sipërfaqet ujore me ujë të ndenjtur dhe ujë të rrjedhshëm të madhësive të ndryshme; liqene, pellgje të mëdha dhe të vogla, moçale, turbiera-kanale, lumenj, kanaleve të gjerë, si edhe në sipërfaqe artificiale të ujore, të tilla si gropa zhavorri, pellgje në parqe dhe kopshte publike.

Biologjia e riprodhimit

Riprodhohet kryesisht në fole notuese, të cilat janë ankoruar në degë ose brenda xunkthave; gjithashtu, folezon përdhe në zona bregdetare, herë pas here edhe në shkurre dhe pemë të vogla; riprodhues i vetmuar; monogam sezonal; 1–2 inkubime në vit; lëshon: 5–10 vezë, periudha e riprodhimit 21–25 ditë; puplimi në 56 ditë, femra ♀ dhe mashkulli ♂ ndërtojnë folenë, rrisin dhe drejtojnë të vegjlit.

Fenologjia

Rezident, si dhe shtegtues i distancave të pjesshme dhe të shkurtra; mbërritja në vendin e riprodhimit në periudhën midis mesit të shkurtit dhe fillimit të marsit; lëshon vezët në periudhën midis mesit të marsit dhe mesit të qershorit; zogjtë e vegjël puplohen nga fillimi i qershorit e tutje.

Kryesisht aktiv gjatë ditës dhe në muzg.

Metodat e censurit

Numërimi i çifteve të izoluara territorial, çiftet dhe mashkulli ♂ që ruan territorin; numërimi i të



rriturve që drejtojnë individët e rinj; përlëshjet territoriale të çiftëve fqinje.

Datat:

1. Fillimi i prillit (numërimi i çiftëve/-individëve dhe të rriturve që riprodhohen);
2. Fillimi i majit (numërimi i çiftëve/-individëve dhe të rriturve që riprodhohen);

3. Fundi i majit në fillim të qershorit (numërimi i çiftëve/individëve dhe të rriturve që riprodhohen).

Koha më e mirë për të numëruar: Numërimi gjatë ditës.

Regjistrimi i riprodhimit: Veçanërisht, nga femra ♀ që drejtojnë, joshin apo paralajmërojnë.

Censusi

Shkurt			Mars			Prill			Maj			Qershor			Korrik			Gusht		
B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E
							(1)		(2)		(3)									

Shënime

Koha e saktë e krijimit të territoreve të riprodhimit është në varësi të kushteve të motit. Femra ♀ dhe mashkulli ♂ shpesh ndajnë të vegjlit midis tyre dhe kjo gjë mund të vërehet në pjesë të ndryshme të territorit.

II.3.11 Shapka e ujit (*Gallinago gallinago*)

Statusi

Status i paqartë i riprodhimit në Shqipëri. Nuk ka listë mbi të dhënat e riprodhimit për këtë lloj në Shqipëri, ndërsa BirdLife International (2014) e ka. Në çdo rast, ka të dhëna të shtegtimit dhe dimërimit të këtij shpendi në Shqipëri (por duhet vënë në dukje se duhet të aplikohen metoda të ndryshme të regjistrimit për të monitoruar shtegtimin dhe dimërimin e individëve).

Tendenca e popullsisë në Evropë: në rënie të moderuar.

Të listuara në Listën e Kuqe Evropiane të Shpendëve – rrezik i ulët.

Habitati

Habitatet hapura deri në gjysmë të hapura, kënetat, zonat e depozitimit të vezëve në zona me ujë të ndenjshëm, shtresa me baltë dhe bimësi të lartë, por më tepër të hapur që ofrojnë strehim.

Biologjia riprodhuese

Riprodhohet përdhe; folezon në terrene të lagështuara, p.sh., midis, barit, shkurreve, kryesisht të fshehura mirë; riprodhues i vetmuar, por foletë mund të jenë, gjithashtu, pranë njëra-tjetrës; mashkulli ♂ dhe femra ♀ (më rrallë) kryejnë fluturime ekspozuese; monogam sezonal në shumicën e rasteve; numri i ngrohjeve 1–2 në vit, zëvendësimi i vezëve i mundshëm; lëshon: 2–5 vezë; Periudha e riprodhimit: 18–20 ditë; të vegjlit puplohen në moshën e 28–35 ditëve.

Fenologjia

Shtegtues i distancave të shkurtra; në rastet

kur çiftet mbërrijnë në vendin e riprodhimit krijimi i territoreve të riprodhimit ndodh nga fillimi i marsit e tutje, aktiviteti më i lartë i paradës nga fillimi i prillit deri fillimi i majit; lëshon vezët në periudhën midis fillimit të prillit dhe fillimit të korrikut; të vegjlit nga fund i prillit e tutje, largimi nga vendi i riprodhimit nga mesi i korrikut e tutje.

Aktiv gjatë ditës dhe natës, kryesisht në muzg dhe agim, në fillim të njohjes dhe të periudhës së shumimit edhe gjatë gjithë ditës dhe, gjithashtu, në netët pa erë me dritë hëne.

Metodat e censurit

Numërimi i të rriturve që shfaqen (fluturim ekspozues, thirrje eksituese nga toka ose në ajër), të dhënat e fluturimeve ndjekëse, numërimin e të rriturve që ruajnë (zogjtë ulen shpesh në hunj përgjatë kullotave), numërimin e të rriturve që drejtojnë zogjtë; regjistrimi mund të jetë i dobishëm për të zbuluar popullatat e izoluara.

Datat:

1. Mesi i prillit deri në fund të prillit (numërimi i individëve të shfaqur);

2. Fillimi i majit (numërimi i individëve të shfaqur dhe i të rriturve që paralajmërojnë);

3. Mesi i majit (numërimi i individëve të shfaqur dhe i të rriturve që paralajmërojnë);

4. Fundi i majit (numërimi i të rriturve që ruajnë/paralajmërojnë dhe, nëse është e mundur, i grupeve të familjeve).

Koha më e mirë për të kryer inventarizimin: Numërimi para lindjes së diellit deri në një orë pas lindjes së diellit dhe një orë para perëndimit të diellit deri në perëndim të diellit.

Regjistrimi i riprodhimit: Veçanërisht nga regjistrimet e të rriturve që drejtojnë të vegjlit.



Censusi

Shkurt			Mars			Prill			Maj			Qershor			Korrik			Gusht		
B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E
							(1)		(2)	(3)	(4)									

Shënime

Në dendësi të larta (> 10 çifte/km²) duhet të realizohen regjistrime të tjera (të paktën 5); shpesh vërehet një aktivitet i madh në lartësi pas shiut apo gjatë motit të nxehtë dhe të lagësht (shi i imët) në pasditen e vonë. Vizualizimi dhe fluturimi ndjekës mund të jetë shumë të gjatë, dhe për këtë arsye pjesërisht të përshtatshëm për identifikimin e territoreve.

Duhet pasur parasysh se shpendët shtegtarë mund të tregojnë, gjithashtu, aktivitetet e të ardhurit rrotull.

II.3.12 Shapka (*Scolopax rusticola*)

Statusi

Të dhënat e riprodhimit në Shqipëri.

Trendi i popullsisë në Evropë: stabil.

Të listuara në Listën e Kuqe Evropiane (Red European) të Shpendëve, si LC – shqetësim i ulët.

Habitati

Pyjet e mëdha, të mirëstrukturuara dhe deri në vargmales malore të ulëta (në varësi të lartësisë), preferon pyje lisi dhe shkoze, pyll moçalor me thupër, verr, pyje të përziera gjethorë, pyje të lagështa me bredh; të një rëndësie të veçantë janë pyjet me strukturën e moshës të ndryshme me boshllëqe në formë kupole dhe me shtresa shkurresh të mirë strukturuara dhe lëndina (p.sh.: livadhe, moçale, lumenj, rrugët pyjore).

Biologjia e riprodhimit

Riprodhohet përdhe; folezon shpesh në buzë të bazamenteve pyjore të mbyllura (p.sh. në livadhe, gjurmët e pyjeve etj., - kudo ku qasja e lirë ajrore është e mundur, kryhen 1–2 inkubime gjatë një viti; depoziton (pothuajse gjithmonë) 4 vezë; Periudha e riprodhimit: 21–24 ditë; të vegjlit puplohen në një

moshë prej rreth 30 ditësh; femra ♀ zgjedh vendin e folesë, rrit dhe drejton zogjtë për rreth 5–6 javë.

Fenologjia

Shtegtues i distancave të largëta. Mbërritja në vendin e riprodhimit fillimi i shkurtit deri në fillim të korrikut; krijimi i çifteve nga fillimi i shkurtit deri fillim të korrikut; lëshimi i vezëve nga mesi i marsit dhe mesi i gushtit; të vegjlit nga mesi dhe fund i prillit e tutje, largimi nga vendi i riprodhimit nga fillimi i shtatorit e tutje.

Aktiv gjatë muzgut dhe natës, fluturimi demonstrues i mashkullit ♂ fillon në muzg dhe zgjat deri në 0.5 orë (deri në 2 orë në fillim të verës), fluturimi demonstrues fillon një orë deri në 10 minuta përpara lindjes së diellit dhe përfundon pothuajse përpara agimit.

Metodat e censurit

Numërimi i meshkujve ♂ të shfaqur (thirrja, fluturimi ekspozues) në vendet e mundshme të shfaqjes (livadh, në pyje, skajet e pyjeve etj.).

Datat:

1. Fillimi i majit deri në mes të majit (numërimi i meshkujve ♂ të shfaqur);
2. Fundi i majit fillimi i qershorit (numërimi i meshkujve ♂ të shfaqur);
3. Fillimi i qershorit deri në fund të qershorit (numërimi i meshkujve ♂ të shfaqur).

Koha më e mirë për të numëruar: 1 orë para perëndimit të diellit deri në errësirë.

Regjistrimi i riprodhimit: Sidomos nga regjistrimet e foleve; regjistrimi i femrave ♀ që drejtojnë të vegjlit (shumë të rrallë dhe kryesisht aksidental).

Censusi

Shkurt			Mars			Prill			Maj			Qershor			Korrik			Gusht		
B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E
									(1)	(2)	(3)									

Shënime

Territoret e meshkujve janë (20 deri në 150 hektarë) dhe një inventarizim real i popullsisë së shapkës nuk është i mundur me metodat e zakonshme. Prandaj, individët mund të regjistrohen vetëm në njësitë e përcaktuara sipërfaqësore. Fushat e inventarizimit duhet të jenë të ndarë në kuadrate prej 1 km². Në çdo sektor

duhet të vendoset një vend vrojtimi pranë një vendi për shfaqje të mundshme (p.sh., livadhe, skajet e pyjeve). Në pyje të mëdha, shumë njerëz duhet të llogarisin në mënyrë të sinkronizuar (një person për një sektor prej 1 km²).

Numërimi duhet të bëhet në netët pa re dhe erë. Netët me një bënë të plotë janë veçanërisht të përshtatshëm.

Shpendët shtegtarë nuk mund të dallohen nga



rezidentët, pasi ata kryejnë, gjithashtu, fluturime ekspozuese.

II.3.13 Pëllumbi i egër (*Columba livia*)

Statusi

Të dhënat e riprodhimit në Shqipëri.

Trendi i popullsisë në Evropë: në rënie.

Të listuara në Listën e Kuqe Evropiane të Shpendëve si LC Red European – shqetësim i ulët.

Habitati

Të çarat përgjatë shkrepave shkëmborë bregdetarë, ose në brendësi të rajoneve malore, grykave, luginat e lumenjve, shpella dhe oazave shkretinore; shpesh në afërsi të sipërfaqeve bujqësore ose vegetacionit të hapur të shkurreve.

Biologjia e riprodhimit

Riprodhohet në shpella dhe të çara të shkëmbinjve të pjerrët; vendet e folezimit janë të vështira për t'u arritur, shpesh në lartësi, në muret vertikale të shkëmbinjve; kryesisht monogamë gjatë gjithë jetës, kryhen disa inkubime gjatë një viti (kryesisht 2–3, por edhe më shumë janë të mundshme); lëshon pothuajse gjithmonë 2 vezë; periudha e riprodhimit: 17–19 ditë; femra♀ rrit dhe drejton të vegjlit; të vegjlit largohen nga foleja në një moshë prej rreth 23–25 ditë dhe puplohen në rreth 30–35 ditë; femra♀ dhe mashkulli♂ ndërtojnë folenë, rrisin e ushqejnë zogjtë e rinj.

Fenologjia

Rezident; riprodhohet në çdo kohë të vitit,

Censusi

Shkurt			Mars			Prill			Maj			Qershor			Korrik			Gusht		
B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E
						(1)	(2)	(3)												

Shënime

Në vendet me densitet të lartë ose në kolonitë madhësia e popullsisë nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme duke numëruar territoret. Në vend të kësaj, duhet të aplikohet një faktor korigjimi: Madhësia e popullsisë = Numri maksimal i të rriturve të numëruar $\times 0.7$.

II.3.14 Turtulli (*Streptopelia turtur*)

Statusi

Të dhënat e riprodhimit në Shqipëri.

Trendi i popullsisë në Evropë: në rënie të moderuar.

Të listuara në Listën e Kuqe Evropiane të Shpendëve si LC Red European – shqetësim i ulët.

por periudha kulmore është nga fillimi i marsit deri në fillim të gushtit.

Aktiv gjatë ditës.

Metoda e censurit

Numërimi i thirrjeve të meshkujve ♂ dhe shfaqja e çifteve; numërimi i çifteve në vendet e mundshme të riprodhimit, i të rriturve që transportojnë materiale për folenë dhe i të rriturve që ushqejnë të vegjlit; të dhënat e thirrjeve kërkuese të individëve të rinj, me dendësi të lartë dhe në kolonitë: Numërimi i individëve.

Datat:

1. Fillimi i marsit deri në mes të prillit (paradat, ndërtimi i folesë, të rriturit që ushqejnë zogjtë, thirrjet kërkuese të individëve të rinj, në vende me densitet të lartë dhe në kolonitë: numërimi i individëve);

2. Fillimi i prillit (paradat, ndërtimi i folesë, të rriturit që ushqejnë të vegjlit, thirrjet kërkuese të individëve të rinj, në vendet me densitet të lartë dhe në kolonitë: numërimi i individëve);

3. Fillimi i majit deri në mes të muajit (paradat, ndërtimi i folesë, të rriturit që ushqejnë zogjtë, thirrjet kërkuese të individëve të rinj).

Koha më e mirë për të numëruar: Numërimi gjatë ditës.

Regjistrimi i riprodhimit: Veçanërisht nga regjistrime të individëve që rrisin dhe që drejtojnë të vegjlit.

Habitati

Në ultësira dhe në lartësi kodrinore në zonat me vend të thatë, fillimisht pyje të thatë, edhe ish-kullota, si dhe toka të ripyllëzuara, me preferencë për lloje habitatesh me një pjesë të madhe dhe në mënyrë të ndërmjetme me shkurre dhe pemë.

Biologjia e riprodhimit

Riprodhohet në fole mbi shkurre dhe pemë përdhe ose në shkëmbinj, kryesisht 1.5–5 m mbi tokë, fole e sheshtë, e hollë me degë të vogla, nganjëherë përdor foletë e tjera si shtresë bazë. Vetëm femra ♀ ndërton fole, mashkulli ♂ sjell materiale. Është riprodhues i vetmuar, monogam sezonal, me 1–2 inkubime gjatë vitit. Lëshon



(pothuajse gjithmonë) 2 vezë. Periudha e riprodhimit është 13–16 ditë. Të vegjlit largohen nga foleja në një moshë prej rreth 18–23 ditësh dhe mbulohen plotësisht me pupla në një moshë prej rreth 25–30 ditë.

Fenologjia

Ky lloj është shtegtues i distancave të gjata. Mbërritja në vendin e riprodhimit është fundi i prillit deri në mes të majit, me meshkujt ♂ që arrijnë të parët. Të ardhurit e tjerë të popullatës vijnë në maj deri në korrik vezët depozitohen nga mesi i majit deri në mes të shtatorit. Individët e rinj puplohen kryesisht nga fillimi i korrikut e tutje dhe largimi nga vendi i riprodhimit ndodh nga mesi i gushtit e tutje. Është aktiv gjatë ditës dhe në muzg, këndon gjatë gjithë ditës me aktivitet më të lartë të kënduarit në mëngjes.

Metodat e censurit

Kryesisht numërimi i të rriturve që thërrasin

Censusi

Shkurt			Mars			Prill			Maj			Qershor			Korrik			Gusht		
B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E
									(1)			(2)			(3)					

Shënime

Fluturimet ekspozuese janë të dukshme, por thirrjet territoriale bëhen shpesh nga pozicione të fshehura. Vetëm një pjesë e meshkujve ♂ thërret, femrat ♀ thërrasin, gjithashtu, por më në heshtje.

II.3.15 Lauresha (*Alauda arvensis*)

Statusi

Të dhënat e riprodhimit në Shqipëri.

Trendi i popullsisë në Evropë: në rënie të moderuar.

Të listuara në Listën e Kuqe Evropiane të Shpendëve si LC Red Evropan – shqetësim i ulët.

Habitati

Habitati në vend të hapur; kryesisht në vendbanime si kullota dhe toka bujqësore, por edhe në toka me shqopishtë, kënetat me kripë, lugina të lagështa drunore dhe livadhe të mëdha pyjore. Frekuenton edhe zona me lagështi deri në të njoma në qoftë se ato janë në kufi me zonat e thata.

Biologjia e riprodhimit

Riprodhohet përdhe, vendi i folezimit është në bar apo bimësi të shkurtër dhe lartësia e

dhe shfaqja e meshkujve ♂ (fluturime ekspozuese); gjithashtu, vëzhgimi i ndërtimit të folesë, i të rriturve që ushqejnë të vegjlit, të vegjlit që nuk janë, mbuluar ende me pupla dhe vendet e ushqimit herët në mëngjes.

Koha:

1. Fillimi i majit deri në fund të muajit (fluturime ekspozuese, thirrjet territoriale, ndërtimi i folesë);

2. Fillimi i qershorit deri në mes të muajit (fluturime ekspozuese, thirrjet territoriale);

3. Fillimi i korrikut deri në mes të muajit (thirrjet territoriale, të rriturit që ushqejnë zogjtë).

Koha më e mirë për të numëruar: Numërimi gjatë agimit deri në 4 orë pas lindjes së diellit.

Regjistrimi i riprodhimit: Veçanërisht nga të rriturit që riprodhohen; të rriturit që ushqejnë zogjtë; individët e rinj të pambuluar me pupla pranë folesë.

preferuar e bimësisë është 15–20 cm. Mashkulli ♂ cakton territorin (këndon në fluturim, këndon nga toka). Është riprodhues i vetmuar, kryesisht monogam sezonal, shpesh me dy inkubime në vit, zëvendësim i vezëve i mundur kur vezët e para humbin, depoziton: 2–5 vezë. Periudha e riprodhimit është 12–13 ditë. Shpendët fluturojnë në një moshë prej rreth 11 ditësh, femra ♀ ushqen dhe mbledh nën krahë të vegjlit e saj, që nuk ushqehen nga mashkulli ♂.

Fenologjia

Rezident ose shtegtar i distancave të shkurtra. Mbërritja në vendin e riprodhimit është nga fillimi i janarit deri në mes të marsit dhe përcaktimi i territoreve nga fillimi i shkurtit e tutje, ndërsa lidhja e çifteve rreth 10 ditë pas mbërritjes në vendin e riprodhimit. Aktiviteti më i lartë i kryerjes së paradave është midis mesit të marsit dhe fund të prillit dhe vezët e ngrohjes së parë lëshohen midis fillimit të prillit dhe mesit të majit, vezët e ngrohjes së dytë depozitohen midis fillimit të prillit dhe mesit të majit, vezët e ngrohjes së tretë depozitohen nga qershori e tutje.



Aktiv gjatë ditës, mashkulli ♂ këndon gjatë gjithë ditës, veprimtaria më e madhe e këndimit në fluturim herët në mëngjes.

Metodat e censurit

Numërimi i meshkujve ♂ që këndojnë (këngë në fluturim dhe këngë nga terreni); të rriturit ushqejnë të vegjlit.

Datat:

1. Fillimi i prillit deri në mes të muajit (kënga);
2. Fundi i prillit (kënga);

Censuri

Shkurt			Mars			Prill			Maj			Qershor			Korrik			Gusht		
B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E	B	M	E
						(1)	(2)	(3)				M.				M.				

Shënime

Gjatë periudhës së riprodhimit, kufijtë e territoreve janë mjaft konstantë në habitate me kullotë, dhe më pak në tokat bujqësore.

Ndërrime të territoreve mund të ndodhin midis ngrohjes së parë dhe të dytë.

Regjistrimi kryhet në mungesë të erës, në kushte të thata të motit. Dubet pasur parasysh se edhe në kushte optimale, mund të ndodhë aktiviteti i ulët i këndimit të shpendëve

II.3.16 Lepuri i egër (*Lepus europaeus*)

Habitati

Lepuri i egër është një lloj me valencë ekologjike të lartë, i cili gjendet në çdo lloj habitati natyror. Densiteti i tij është i lidhur pozitivisht me llojshmërinë e habitatit. Habitatet me bimë barishtore dhe kullota të freskëta janë vendet tipike ku gjendet lepur i egër. Megjithatë, praktikat bujqësore të intensifikuara kanë reduktuar këtë burim ushqimi për lepurin e egër.

Cikli i riprodhimit

Lepuri i egër pjell mesatarisht 3–4 herë këlyshë në vit. Madhësia e këlyshëve të lindur ndryshon në varësi të sezonit. Këlyshët e lindur në fillim të pranverës janë më të vegjël se sa ata të lindur në vjeshtë. Këlyshët lindin 41–42 ditë pas ndërzimit dhe pas një viti këlyshët maturohen.

Popullata

Popullata e lepurit të egër ka pasur rënie në shumë zona në të gjithë shtrirjen gjeografike të tij në Shqipëri. Dendësia e popullatës në Evropë varion nga 0.1/ha deri në 3.4/ha.

Metodat e monitorimit

Numërimet me prozhektor:

Numërimet me prozhektor janë metodat më të sigurta, por të vështira për t'u aplikuar.

3. Fillimi i majit (kënga, të rriturit që ushqejnë të vegjlit).

Koha më e mirë për të inventarizuar: Inventarizimi gjatë agimit deri në 4 orë pas lindjes së diellit, në fillim të periudhës të shumimit edhe gjatë ditës deri në fillim të mbrëmjes (por jo rreth mesditës).

Regjistrimi i riprodhimit: Veçanërisht nga të rriturit që ushqejnë të vegjlit.

Metoda mund të sigurojë vlerësime të besueshme vetëm nëse numri i lepujve është i lartë dhe në zonë ka akses për automjetet. Ka metodologji të ndryshme për numërimin me prozhektor. Shembulli i njëres nga metodat shpjegohet si më poshtë. Lepujt numërohen 2–3 herë në pranverë, kur ata janë ende të dukshëm në bimësi të ulët. Shtigjet e parazgjedhura përkohën me makinë gjatë natës (me një shpejtësi prej 4–10 km/h), ndriçohen me një prozhektor (me një rreze prej 200 m) dhe të gjithë lepujt e vëzhguar regjistrohen në një hartë dhe kontrollohen për një numërim të dytë. Vëzhgimi duhet të fillojë të paktën një orë pas perëndimit të diellit dhe duhet bërë në të njëjtën periudhë çdo natë.

Mjetet: Një makinë 4x4, 4 persona (1 shofer, 2 vëzhgues me prozhektor, 1 regjistruer), prozhektor me fuqi ndriçimi prej 200.000 cd me rreze ndriçimi prej 200 m dhe dylbi.

Kufizimet: Moti duhet të jetë i mirë jo me mjegull, borë ose me erë të fortë. Zonat e mbuluara nga metoda janë të mëdha ose mund të jenë zona të hapura bujqësore me përqindje të ndryshme të mbulesës bimore dhe tokat bujqësore. Kjo nuk është metoda më e përshtatshme në Alpe, sepse struktura e habitatit ndikon shumë në rezultatet e regjistrimit. Zonat pyjore brenda zonës së vrojtimit nuk mund të përfshihen në monitorimin me prozhektorë.

Linjat e kalimeve tërthore:

Kalimet tërthore janë të lehtë për t'u realizuar, kërkojnë një punë jointensive dhe mund të aplikohen për zona të mëdha. Kalimet tërthore të realizuara bëhen 2.5 deri në 4.6 km, por edhe mund të zgjaten në mënyrë të konsiderueshme. Kalimet



tërthore duhet të jenë përafërsisht të drejta. Për çdo lepur të parë, maten koha dhe distanca kënddrejtë nga linja e prerjes së tërthortë. Vlerësimi i densitetit mund të bëhet nga vlerësimi i densitetit për secilën pjesë ose duke përdorur funksionin e zbulimit, megjithatë mënyra më efikase vendoset më vonë gjatë zbatimit të kësaj metode. Linjat kalimeve tërthore duhet të kryhen vetëm në periudhën midis tetorit dhe janarit.

Numërimi i jashtëqitjeve përgjatë gjurmimit:

Jashtëqitjet e numëruara mund të vlerësohen në fusha të veçanta, por ato janë të vështira për t'u aplikuar në një gamë të gjerë habitatesh. Jashtëqitjet mbeten të paprekura për të paktën 60 ditë, në kushtet klimatike subalpine dhe alpine për shumë vite. Të gjitha jashtëqitjet përgjatë kalimeve të tërthorta duhet të hiqen para studimit fillestar. Madhësia e parcelës dhe koha midis matjeve mund të ndryshohet sipas kushteve. Në përgjithësi rekomandohet madhësi e vogël e parcelës dhe madhësi e madhe e mostrës (= numri i transekteve).

Parcelat (ato duhet të shënohen për të matur gjithmonë të njëjtat parcela) duhet të jenë përafërsisht 5 m secila përgjatë gjurmimit. Madhësia e parcelave varet nga lloji i habitateve ose mënyrës së menaxhimit të një zone.

II.3.17 Dhelpra (*Vulpes vulpes*)

Habitati

Dhelpra gjendet në habitate të ndryshme, si: tundra, shkretëtira dhe pyje, si dhe në qendrat e qyteteve. Habitati natyror është i thatë, peizazhe të përziera, rrëzë pyjeve dhe shkurre. Ato janë, gjithashtu, të pranishme në male (madje edhe mbi kufirin e pyllit, e njohur për të kapërcyer vendkalimet alpine), shkretëtira, dunat e rërës dhe tokat bujqësore me një lartësi 4500 m nga niveli i detit. Në shumë habitate, dhelpra duket të jetë e lidhur ngushtë me njeriun, madje jeton edhe në zonat intensive bujqësore.

Cikli i riprodhimit

Dhelprat rrinë zakonisht së bashku në çifte apo grupe të vogla të përbëra nga familje, të tilla si një çift dhe të vegjlit e tyre apo një mashkull me disa femra që kanë lidhje farefisnore. Të rinjtë e çiftit mbeten me prindërit e tyre për të ndihmuar në përkujdesjen e këlyshëve të rinj. Dhelpra riprodhohet një herë në vit në pranverë. Numri mesatar i këlyshëve varion nga 4–6 këlyshë, në raste të veçanta mund të pjellë edhe 13 këlyshë. Pjelljet e

mëdha janë tipike në zonat ku vdekshmëria e dhelprës është e lartë.

Metodat e monitorimit

Vrojtimi i shenjave bazuar në numërimin e jashtëqitjeve:

Zonat e përcaktuara të gjurmimit pastrohen nga të gjitha jashtëqitjet, për t'u kthyer më pas dhe për të mbledhur të gjitha jashtëqitjet e hasura dy javë më vonë. Si një alternativë në vend të heqjes të jashtëqitjeve të vjetra, ato mund të lihen në vend, por të shënohen në mënyrë që të njihen. Kjo metodë siguron një vlerësim të numrit relativ. Indeksi mund të standardizohet në jashtëqitje/km. Për një monitorim afatgjatë, gjurmimi i jashtëqitjeve duhet të kryhet përgjatë të njëjtës rrugë në të njëjtën kohë të vitit.

Vrojtimet e bazuara në numërimin e gjurmëve ndjekin të njëjtin parim, por është shumë më të vështira për t'u aplikuar. Kushtet më të mira në periudhën e dimrit është kërkimi i gjurmëve, 1–2 ditë pas rënies së dëborës. Vrojtimi nuk mund të planifikohet në një fazë të avancuar, por duhet të organizohet në një kohë të shkurtër. Gjurmët e dhelprës ngatërrohen ndonjëherë me gjurmët e qenit.

Shënime

Më tej metodat të tjera indirekte janë numërimi me prozbektor, numërimi i shtrofullave të riprodhimit dhe markimet me urinë. Megjithatë, të gjithë këto kanë edhe kufizimet e tyre dhe janë më pak të rekomanduara për dhelprën e kuqe.



SKEDA E DOKUMENTACIONIT TË INVENTARIZIMIT

BASHKIA _____

Lloji i faunës së egër	Zona e gjuetisë	Stacioni i inventarizimit	Pika përkatëse	Numri i individëve			Nr. i vezëve	Data e inventarizimit	Koha (ora)	Të tjera
				gjithsej	meshkuj	femra				
1.										
2.										
3.										
4.										
5.										
6.										
7.										
8.										
9.										
10.										
11.										
12.										
13.										
14.										
15.										
16.										
17.										

Inventarizuesi

Menaxhuesi

**UDHËZIM****Nr. 4, datë 15.2.2016****PËR PROCEDURAT NË ZBATIM TË
LIGJIT NR. 146/2015, DATË 17.12.2015,
“PËR PUNËKËRKUESIT”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 9, të nenit 4, të ligjit nr. 146/2015, datë 17.12.2015, “Për punëkërkuesit”,

UDHËZOJ:**I. Regjistrimi i punëkërkuesit dhe statusi i tij në zyrën e punësimit**

1. Çdo person, që jeton në Republikën e Shqipërisë dhe kërkon të regjistrohet si punëkërkues, të drejtohet në zyrën përkatëse të punësimit. Zyra përkatëse e punësimit regjistron si punëkërkues personin që:

- a) Është në moshë pune;
- b) Paraqitet personalisht me një dokument identifikimi;
- c) Kërkon punë;
- d) Është i aftë dhe i gatshëm për punë.

Personi, që deklaron se nuk është në marrëdhënie pune apo i vetëpunësuar, paraqet në zyrën e punësimit librezën e punës, nëse ka një të tillë.

2. Zyra përkatëse e punësimit planifikon një intervistë të plotë regjistrimi për vlerësimin e punësueshmërisë së punëkërkuesit, përcaktimin e profilit të tij, nevojën për shërbime dhe planin e veprimeve për punësim.

Në sistemin e shërbimeve të punësimit dhe në formularin standard për regjistrimin e punëkërkuesit regjistrohen të dhënat e identitetit të punëkërkuesit dhe informacioni për aftësitë, njohuritë, kompetencat, aktivitetin e kërkimit të punës, motivimin për punë dhe pritshmërinë për punësim në tregun aktual të punës.

Punëkërkuesi i regjistruar firmos formularin e regjistrimit për të konfirmuar vërtetësinë e deklaramit dhe për të lejuar zyrën e punësimit të përpunojë dhe përdorë të dhënat e deklaruara.

3. Personi i regjistruar mban statusin “Punëkërkues”. Zyra përkatëse e punësimit vendos për dhënin e statusit “Punëkërkues i papunë” brenda një muaji kalendarik, nga data e paraqitjes së tij për intervistën e plotë të regjistrimit, pasi verifikon deklaramin e tij si

punëkërkues dhe gjendjen e punësimit në regjistrin e organeve tatimore.

Dhënia e statusit “Punëkërkues i papunë” regjistrohet në sistemin e shërbimeve të punësimit dhe në formularin e punëkërkuesit. Punëkërkuesi, me këtë status në sistem, mund të verifikohet drejtpërdrejt nga institucionet e tjera, të lidhura me sistemin e shërbimeve të punësimit, apo nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al.

4. “Punëkërkues i papunë” përfiton shërbime punësimi dhe pjesëmarrje në programet aktive të punësimit, apo programet e tjera shtetërore të mbështetjes me të ardhura, si më poshtë:

- a) Informacion mbi vendet e lira të punës;
- b) Ndërmjetësim për punësim;
- c) Këshillim dhe orientim për karrierë, profesion dhe punësim, për:
 - i) zgjedhjen e një profesioni të përshtatshëm me cilësitë individuale të kërkuar në tregun e punës;
 - ii) identifikimin e aftësive të munguara dhe ofrimin e mjeteve të përshtatshme për plotësimin e tyre, si arsimimin ose formimin profesional;
 - iii) identifikimin e qëllimit të punësimit, qasjen në punësim, mundësitë e kualifikimeve, si dhe për të kuptuar aftësitë e nevojshme për të kërkuar e mbajtur një vend pune.
- d) Formim profesional falas në qendrat publike të formimit profesional;
- e) Pjesëmarrje në masat e nxitjes së punësimit;
- f) Përfitim të pagesës së papunësisë;
- g) Vërtetimin e papunësisë.

Pas përfitimit të statusit “Punëkërkues i papunë”, ai pajiset nga zyra përkatëse e punësimit me “Kartelën e punëkërkuesit të papunë”, sipas formatit unik të miratuar nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

5. Zyra përkatëse e punësimit vërteton për institucionet e tjera të qenit i papunë vetëm për punëkërkuesin, që mban statusin “Punëkërkues i papunë”, nëpërmjet:

- a) Listave emërore me të dhënat e identitetit;
- b) Lidhjes së drejtpërdrejtë të institucioneve në sistem;
- c) Portalit unik qeveritar e-albania.al.

Punëkërkuesi i papunë mund ta vërtetojë këtë status edhe duke paraqitur pranë institucioneve të tjera kartelën e punëkërkuesit të papunë, të konsideruar të vlefshme në bazë të datës së fundit të paraqitjes, brenda afatit njëmuajor, të



konfirmuar me shënimet dhe identifikimin e specialistit dhe të vulosur nga institucioni.

Zyra e punësimit, për raste të veçanta, vërteton statusin e punëkërkuarit të papunë për institucionin, që e kërkon atë me anë të vërtetimit të lëshuar prej saj, sipas formatit tip të miratuar nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

6. Në zyrën e punësimit mund të regjistrohet për të kërkuar punë ose një punë të re edhe personi, që deklaron se është në marrëdhënie pune ose i vetëpunësuar.

Pas vlerësimit të punëkërkimit personi do të regjistrohet në sistem dhe në formularin përkatës me statusin “Punëkërkuar”. Personi me këtë status do të përfitojë shërbimet e punësimit për gjetjen e një pune të re apo përgatitje për punë, informacion për vendet e lira të punës, këshillim për punë e profesion dhe ndërmjetësim në punë.

I regjistruari si “Punëkërkuar” nuk pajiset me kartelën e punëkërkuarit të papunë dhe nuk përfiton vërtetim nga zyra e punësimit me qëllim përfitimi nga programet shtetërore të mbësh-tetjes me të ardhura. Për këtë “Punëkërkuar” nuk shfaqen të dhëna në sistemet e institucioneve të tjera, të lidhura me sistemin e shërbimeve të punësimit.

Ai nuk përfiton falas pjesëmarrjen në kurset e formimit profesional në qendrat publike dhe nuk mund të jetë pjesëmarrës në programet e nxitjes së punësimit për punëkërkuarit e papunë.

Si kërkuar pune me status “Punëkërkuar” mund të regjistrohen në zyrën e punësimit edhe studentët, që vazhdojnë studimet, të cilët u drejtohen zyrave të punësimit për të kërkuar një punë me kohë të pjesshme.

Në rast se, gjatë periudhës së regjistrimit, punëkërkuari ndërpret marrëdhëniet e punës aktuale, pas verifikimit në regjistrin e organeve tatimore, zyra e punësimit vendos për dhënien e statusit të punëkërkuarit të papunë.

7. Kur punëkërkuari paraqitet për të kërkuar punë në një zyrë tjetër punësimi nga ajo që ushtron veprimtarinë në zonën e vendbanimit të tij të përhershëm, i konfirmuar ky vendbanim edhe nga lidhja në sistem me regjistrin e gjendjes civile, zyra e punësimit verifikon regjistrimin si punëkërkuar në bazën e të dhënave të sistemit të shërbimeve të punësimit.

- Nëse personi nuk rezulton i regjistruar, vazhdon procedurat e plota për vlerësim dhe regjistrim në zyrën ku është paraqitur.

- Nëse personi rezulton i regjistruar si punëkërkuar, bën një rivlerësim të punësueshmërisë së tij, verifikon statusin e punësimit dhe kategorinë në të cilën është klasifikuar nga zyra përkatëse, që ka bërë regjistrimin.

Punëkërkuari i regjistruar përfiton ose jo nga shërbimet e punësimit dhe programet që ofron zyra e punësimit, në varësi të statusit të tij në zyrë “Punëkërkuar” apo “Punëkërkuar i papunë”.

8. “Punëkërkuari i papunë” i regjistruar në zyrën tjetër të punësimit përfiton të gjitha shërbimet e punësimit dhe të përgatitjes për punë, formim profesional falas në qendrat publike të formimit dhe pjesëmarrje në programet e nxitjes së punësimit, për të cilat aktet përkatëse nënligjore të programit nuk e kushtëzojnë përfshirjen në varësi të vendbanimit të përhershëm. Edhe për të përfituar pagesën e të ardhurave nga papunësia ai duhet të drejtohet në zyrën përkatëse ku ka vendbanimin e përhershëm.

Territori, që ka në juridiksion zyra përkatëse e punësimit, sipas ndarjes administrativo-territoriale të njërive administrative, paraqitet në shtojcën nr. 1 “Kompetencat territoriale të zyrës së punësimit”, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Shërbimi Kombëtar i Punësimit të bëjë përditësimet me këtë ndarje territoriale në sistemin e shërbimeve të punësimit.

9. Punëkërkuari i papunë duhet të paraqitet në zyrën e punësimit çdo muaj ose sa herë që thirret pranë saj për ofrimin e një punësimi të përshtatshëm, për pjesëmarrje në programet nxitjes së punësimit apo të formimit profesional, për të cilat zyra e përzgjedh si kandidat të përshtatshëm. Në takimin e planifikuar punëkërkuari duhet të deklarojë përpjekjet individuale për kërkimin e punës.

10. Për të gjithë punëkërkuarit e regjistruar, të paktën një herë në gjashtë muaj, bëhet një riintervistim për rishikimin e profilit, vlerësimin e punësueshmërisë së tyre dhe rishikimin e planeve individuale të punësimit.

11. Në çdo rast, që zyra e punësimit verifikon se informacioni i punëkërkuarit nuk është i vërtetë, e thërret për riintervistë dhe pas saj vendos për heqjen ose jo të statusit të punëkërkuarit, sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim.



II. Kategorizimi i punëkërkuesve të papunë

Punëkërkuesit e papunë të regjistruar në zyrën e punësimit kategorizohen në tre nëngrupe.

1. “Punëkërkues, që përfitojnë ndihmë ekonomike”

Në këtë kategori klasifikohen punëkërkuesit, që kanë fituar statusin “Punëkërkues i papunë”, pas procedurave standarde të vlerësimit dhe regjistrimit si të tillë në zyrën e punësimit, për të cilët njësi administrative konfirmon që ka miratuar mbështetjen e tyre me të ardhura nga ky program shtetëror. Konfirmimi merret me shkrim ose nëpërmjet sistemit, kur kjo mundësohet. Të dhënat plotësohen në sistem, në formularin e regjistrimit dhe në kartelën e punëkërkuesit të papunë.

Në fund të çdo muaji zyra e punësimit njofton me shkrim institucionin përgjegjës për punëkërkuesit e papunë, përfitues të ndihmës ekonomike, që çregjistrohen për arsye punësimi apo që u heq statusin, duke përshkruar arsyen përkatëse, me qëllim marrjen e masave në përputhje me legjislacionin në fuqi. Verifikimi i statusit “Punëkërkuesi i papunë” nga njësi administrative, kur mundësohet bëhet nëpërmjet sistemit.

2. “Punëkërkues, që përfitojnë pagesë papunësie”

Në këtë kategori klasifikohen punëkërkuesit, që kanë fituar statusin “Punëkërkues i papunë”, pas procedurave standarde të vlerësimit dhe regjistrimit si të tillë në zyrën e punësimit, për të cilët zyra e punësimit vendos të miratojë kërkesën për përfitimin e të ardhurës nga papunësia, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore përkatëse. Gjatë periudhës së papunësisë, zyra i jep përparësi mundësive të punësimit, për rikthimin sa më shpejt në tregun e punës ose përfshirjes në programet aktive të punësimit e formimit profesional.

Në përfundim të periudhës së përfitimit, nëse punëkërkuesi nuk është punësuar, do të ndryshojë kategorinë në të cilën është klasifikuar për efekt të mbështetjes me të ardhura.

3. “Punëkërkues të tjerë”

Në këtë kategori klasifikohen të gjithë punëkërkuesit që kanë fituar statusin “Punëkër-

kues i papunë”, të cilët nuk përfitojnë nga programet e mbështetjes me të ardhura të përshkruara më sipër, dhe i drejtohen zyrës së punësimit për të marrë shërbime punësimi e përgatitje për punë, për t'u punësuar në një vend pune të përshtatshëm apo për të përfituar nga pjesëmarrja në programet aktive që ajo zbaton.

Në këtë kategori do të klasifikohen dhe punëkërkuesit, të cilët kanë si kusht përfitimi të qenit punëkërkuesi i papunë, i regjistruar në zyrën e punësimit, për të përfituar të ardhura nga programe të tjera shtetërore të mbështetjes me të ardhura, të miratuara me akte ligjore të veçanta.

III. Çregjistrimi i punëkërkuesit të papunë, heqja/refuzimi i statusit në zyrën e punësimit

1. Zyra përkatëse e punësimit i heq statusin “Punëkërkues i papunë” ose vendos të mos ia japë atë personit, që pretendon ta fitojë, nëse ai deklaron se nuk pranon të punësohet në një vend pune të paguar në përshtatje me:

a) Karakteristikat e tij individuale (moshën, gjininë, kushtet shëndetësore);

b) Kualifikimin dhe aftësitë e tij profesionale (arsimimin, formimin profesional, kohëzgjatjen e punësimit të mëparshëm, përvojën e fituar);

c) Vendbanimin dhe ndikimin e punës në fjalë në gjendjen personale dhe familjare.

Punëkërkuesi, që humb statusin, për arsye të mos pranimit të punësimit në një vend pune të përshtatshëm, çaktivizohet në sistemin e shërbimeve të punësimit, duke u çregjistruar me arsyen “Refuzon vendin e punës” dhe nuk shfaqet në sistemet e institucioneve të tjera të lidhura me të.

2. Zyra përkatëse e punësimit i heq statusin “Punëkërkues i papunë”, ose vendos të mos ia japë atë personit, që pretendon ta fitojë, nëse ai deklaron në zyrën e punësimit, se nuk kërkon punë. Punëkërkuesi, që humb statusin për këtë arsye çaktivizohet në sistemin e shërbimeve të punësimit, duke u çregjistruar me arsyen “Nuk kërkon punë”, dhe nuk shfaqet në sistemet e institucioneve të tjera të lidhura me të.

3. Zyra përkatëse e punësimit i heq statusin “Punëkërkues i papunë” punëkërkuesit, që deklaron se nuk pranon të marrë pjesë në një nga programet e nxitjes së punësimit apo programe të tjera të ofruara prej saj, për t'u punësuar apo mësuar një profesion të përshtatshëm, që e ndihmon atë për t'u integruar në tregun e punës.



Punëkërkuksi, që humb statusin për arsye të mos pjesëmarrjes në program, çaktivizohet në sistemin e shërbimeve të punësimit, duke u çregjistruar me arsyen “Refuzon pjesëmarrjen në program” dhe nuk shfaqet në sistemet e institucioneve të tjera të lidhura me të.

4. Zyra përkatëse e punësimit i heq statusin “Punëkërkuks i papunë” punëkërkuksit, që deklaron se nuk pranon të aftësohet nëpërmjet formimit profesional të ofruar falas në qendrat publike të formimit profesional, në rastin kur formimi vlerësohet i përshtatshëm në përputhje me karakteristikat e tij individuale dhe me kërkesat që ka tregu e punës.

Punëkërkuksi, që humb statusin për arsye të këtij mospranimi çaktivizohet në sistemin e shërbimeve të punësimit, duke u çregjistruar me arsyen “Refuzon formimin profesional” dhe nuk shfaqet në sistemet e institucioneve të tjera të lidhura me të.

5. Zyra përkatëse e punësimit i heq statusin “Punëkërkuks i papunë” edhe punëkërkuksit që nuk paraqitet në takimin e planifikuar në zyrën e punësimit, sipas afateve të përcaktuara në ligj apo kur i kërkohet një gjë e tillë.

Nëse punëkërkuksi nuk bën një njoftim paraprak për të arsyetuar mosparaqitjen në takimin e planifikuar dhe për të konfirmuar një datë tjetër takimi në adresat (të dhënat) e kontaktit, të vëna në dispozicion nga zyra për këtë qëllim dhe nuk e dokumenton mosparaqitjen në takimin më të afërt në zyrën e punësimit, ai humb statusin e punëkërkuksit të papunë dhe çregjistrohet me arsyen “Nuk u paraqit në zyrën e punësimit”.

6. Rastet e tjera të çregjistrimit të punëkërkuksit të papunë dhe ndryshimit të statusit të tij janë ato kur:

a) Punëkërkuksi i papunë punësohet në një punë të përshtatshme me ndërmjetësimin e zyrës së punësimit dhe çregjistrohet me arsyen “Ndërmjetësim në punë”;

b) Punëkërkuksi i papunë punësohet në një vend të lirë pune, të cilin e gjen vetë si rezultat i kërkimit individual gjatë periudhës, që merr shërbime punësimi në zyrën e punësimit, apo kur ai punësohet në një nga vendet e lira të shpallura në zyrën e punësimit, për të cilin merr informacion gjatë vizitave në zyrë apo në portalin *online* të shërbimeve të punësimit

<http://puna.gov.al/> ose në faqen zyrtare të SHKP <http://www.shkp.gov.al/>. Në këtë rast, ai çregjistrohet me arsyen “Ka gjetur punë vetë”;

c) Punëkërkuksi i papunë punësohet nëpërmjet pjesëmarrës në një program të nxitjes së punësimit dhe çregjistrohet me arsyen “Pjesëmarrës në program nxitje punësimi”.

7. Propozimi për punësim apo pjesëmarrjes në programe regjistrohet në sistemin e shërbimeve të punësimit dhe formularin përkatës. Për çdo rast mospranimi apo refuzimi punëkërkuksi nënshkruan deklaratën me arsyen përkatëse. Zyra e punësimit merr vendimin për heqjen/refuzimin ose jo të statusit të punëkërkuksit të papunë, pasi shqyrton deklaratimet përkatëse rast pas rasti.

Deklarata e nënshkruar i bashkëngjitet formularit të regjistrimit. Në rast të mos nënshkrimit të deklaratimit nga punëkërkuksi, deklarata firmoset vetëm nga specialisti me shënimin “Punëkërkuksi refuzon të nënshkruajë”.

Formati i deklaratës për konfirmimin e mospranimit të punësimit apo pjesëmarrjes në programe i bashkëngjitet këtij udhëzimit në shtojcën nr. 2.

8. Kur vendimi për heqjen e statusit të punëkërkuksit të papunë ankimohet nga punëkërkuksi, shqyrtimi dhe vendimmarrja bëhet nga një grup vlerësimi, i ngritur nga titullari i zyrës përkatëse të punësimit për këtë qëllim.

9. Personi, të cilit i refuzohet apo i hiqet statusi “Punëkërkuksi i papunë”, ka të drejtë për të aplikuar për regjistrim në zyrën e punësimit dhe për ta rifituar atë, vetëm pas një periudhe kohe tremujore.

Afati i llogaritjes së kësaj periudhe kohore do të bazohet mbi datën, në të cilën është bërë çregjistrimi i tij në sistem dhe në formularin përkatës të regjistrimit në zyrën e punësimit.

IV. Për ndjekjen dhe zbatimin e dispozitave të tjera ligjore

1. Zyra e punësimit informon Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe merr konfirmim prej tij për vendin e lirë të punës, të shpallur nga punëdhënësi në zyrën e punësimit, i cili refuzohet nga pjesa më e madhe e punëkërkuksve të përzgjedhur si kandidatë të përshtatshëm për t'u punësuar në të, me arsyen e kushteve të papërshtatshme të punës dhe pagesës, sipas legjislacionit në fuqi.



2. Për zbatimin e afateve të paraqitjes të punëkërkesve të papunë, për të cilët datat e paraqitjes në zyrën e punësimit dhe procedurat përkatëse janë përcaktuar përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 146/2015, datë 17.12.2015, “Për punëkërkesit” dhe këtij udhëzimi, të vijnë takimet në zyrën e punësimit, deri në datën më të fundit të planifikuar dhe të informohen për ndryshimet ligjore në vazhdim.

3. Shërbimi Kombëtar i Punësimit nxjerr rregulloren për procedurat që ndjek zyra e punësimit në zbatim të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE DHE
RINISË
Blendi Klosi

SHTOJCA NR. 1

TERRITORI NË JURIDIKSION TË ZYRAVE TË PUNËSIMIT NË PËRPTHJE ME NDARJEN E RE ADMINISTRATIVE SIPAS LIGJIT NR. 115/2014, “PËR NDARJEN ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Nr.	Zyra e punësimit	Njësitë e qeverisjes vendore
1.	Qarku Berat	Bashkia
	DRSHKP Berat	Berat
	ZVSHKP Kuçovë	Kuçovë
	ZVSHKP Skrapar	Skrapar Poliçan
2.	Qarku Dibër	Bashkia
	DRSHKP Dibër	Dibër
	ZVSHKP Bulqizë	Bulqizë
	ZVSHKP Mat	Mat Klos
3.	Qarku Durrës	Bashkia
	DRSHKP Durrës	Durrës Shijak
	ZVSHKP Krujë	Krujë
4.	Qarku Elbasan	Bashkia
	DRSHKP Elbasan	Elbasan Cërrik Belsh
	ZVSHKP Peqin	Peqin
	ZVSHKP Gramsh	Gramsh
	ZVSHKP Librazhd	Librazhd Përrenjas
5.	Qarku Fier	Bashkia
	DRSHKP Fier	Fier Patos Roskovec
	ZVSHKP Lushnjë	Lushnjë Divjakë
	ZVSHKP Mallakastër	Mallakastër
6.	Qarku Gjirokastrë	Bashkia



	DRSHKP Gjirokastrë	Gjirokastrë
		Libohovë
		Dropull
	ZVSHKP Tepelenë	Tepelenë
		Memaliaj
	ZVSHKP Përmet	Përmet
		Këlcyrë

Nr.	Zyra e punësimit	Njësitë e qeverisjes vendore
7.	Qarku Korçë	Bashkia
	DRSHKP Korçë	Korçë
		Maliq
		Pustec
	ZVSHKP Devoll	Devoll
	ZVSHKP Kolonjë	Kolonjë
ZVSHKP Pogradec	Pogradec	
8.	Qarku Kukës	Bashkia
	DRSHKP Kukës	Kukës
	ZVSHKP Has	Has
	ZVSHKP Tropojë	Tropojë
9.	Qarku Lezhë	Bashkia
	DRSHKP Lezhë	Lezhë
	ZVSHKP Mirditë	Mirditë
	ZVSHKP Kurbin	Kurbin
10.	Qarku Shkodër	Bashkia
	DRSHKP Shkodër	Shkodër
		Vau i Dejës
	ZVSHKP Malësi e Madhe	Malësi e Madhe
	ZVSHKP Pukë	Pukë
		Fushë-Arrëz
11.	Qarku Tiranë	Bashkia
	DRSHKP Tiranë	Tiranë
		Kamzë
		Vorë
	ZVSHKP Kavajë	Kavajë
Rrogozhinë		
12.	Qarku Vlorë	Bashkia
	DRSHKP Vlorë	Vlorë
		Selenicë
		Himarë
	ZVSHKP Delvinë	Delvinë
		Finiq
	ZVSHKP Sarandë	Sarandë
		Konispol



SHTOJCA NR. 2
FORMATI I DEKLARIMIT NË ZYRËN E PUNËSIMIT



SHËRBIMI KOMBËTAR I PUNËSIMIT
DREJTORIA RAJONALE/ ZYRA VENDORE E PUNËSIMIT

Z./znj. _____

emër, atësi, mbiemër

Paraqitur në zyrën e punësimit më datë ____ .201__

Deklaron si më poshtë:

1. Nuk kërkon punë.....

2. Refuzon vendin e punës

Përshkrimi i vendit të punës.....

.....

3. Refuzon pjesëmarrjen në programin e nxitjes së punësimit:

Përshkrimi i programit të ofruar (VKM/profisioni/ndërmarrja)

.....

4. Refuzon formimin profesional falas:.....

Përshkrimi i formimit/kursit të ofruar.....

.....

Arsyeja e mospranimit:

.....

Punëkërkuesi
(emër, mbiemër, nënshkrim)

Specialisti
(emër, mbiemër, nënshkrim)

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 224 lekë